



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Administrim Publik”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Anisa SUBASHI

Dr. Ejona ISUFAJ

Janar / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT Master
Profesional në “Administrim Publik”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Administrimit Publik
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Administrim Publik”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr. 795, datë 06.10.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 7, datë 07.05.20128 Miratuar nga MASR me shkresë Nr. 5348/1 prot, datë 12.06.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASH nr.125, datë 29.03. 2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023: 13 PAE / 0 PAK 2021-2022: 13 PAE / 1 PAK 2020-2021: 12 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022-2023: 17 Viti akademik 2021-2022: 32 Viti akademik 2020-2021: 44
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik” ofrohet nga Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër në Fakultetin Ekonomik, specifikisht në Departamentin e Administrimit Publik. Programi është licensuar fillimisht nëpërmjet VKM Nr. 795, datë 06.10.2010 dhe ka filluar veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011. Programi është riorganizuar nga Master Profesional me 90 kredite në Master Profesional me 120 kredite, sipas Vendimit të Senatit Nr. 7, datë 07.05.20128, dhe miratuar nëpërmjet shkresës Nr. 5348/1 datë 12.06.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se Fakulteti Ekonomik përbëhet nga tre departamente. Këto departamente ofrojnë programe të ciklit të parë, të dytë dhe programe me karakter profesional.

Programi i Studimit Master Profesional në “Administrim Publik” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, 120 ECTS dhe kohë zgjatje të rregullt 2 vite akademike.

Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik” i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe sipas drejtuesve të IAL është konceptuar në përputhje me standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë dhe sidomos kërkesat e tregut të punës në Shqipëri.

Nga takimi me studentë të këtij programi studimi doli në pah që ata mbështeten shumë nga stafi akademik duke përfshirë studentët në punët e tyre kërkimore, organizmin e konferencave, organizimin e eventeve dhe përditësimin në të rehat më të fundit në fushën e shkencave politike si edhe atë të integritetit evropian.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)


Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga **Dr. Anisa Subashi** dhe **Dr. Ejona Isufaj**. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Msc. Erion Xhako, përfaqësues i ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë Master Profesional në “Administrim Publik”, si edhe ofron sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të politologëve të rinj.

Më datë 15.01.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.27 Prot., datë 15.01.2025, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 23.01.2025, dhe me shkresë zyrtare Nr. 70/1 Prot., datë 23.01.2025, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

Pasi shqyrtuam komentet e ardhura nga institucioni ne si ekspertë të jashtëm konkludojmë që institucioni është i dakordësuar me draft raportin e vlerësimit të jashtëm (DRVJ) prandaj gjykojmë që ky draft dërgohet tani nga ana jonë si Raport i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Bachelor në “Administrim Publik” në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër.



Lidhur me komentet mbi konkluzionet e GVJ-së për Standardin II.I, Kriteri 7

GVJ pranon se programet e ciklit të dytë të studimit, Master Profesional në Administrim Publik, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi me universitetet publike në Shqipëri kanë përmbajtje të ngjashme (së paku 70 %), janë konsistente dhe ofrojnë një përvojë të ngjashme të mësimit për studentët duke garantuar cilësinë dhe standardet e barabarta për të gjithë studentët në këto programe. Prandaj,...

Vlerësimi në këtë pikë ndryshon



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në

“ Administrim Publik”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Të gjitha programet e studimit të ofruara nga Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, janë në linjë me politikat kombëtare, në veçanti me punësimin e të rinjve dhe nxitjen e sipërmarrjes, kreativitetit dhe inovacionit. Universiteti ofron program studimi në përputhje me standardet më të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fusha të ndryshme, me qëllim që të përgatisë profesionistë të këtyre fushave dhe të çojë përpara kërkimin shkencor në këto fusha, duke i paraprirë në këtë aspekt dinamikës së ndryshimeve të shoqërisë shqiptare. <i>Evidenca I.3: Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025</i> <i>Evidenca I.1: Statuti i UGJ</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik” është në përputhje me misionin dhe objektivat e zhvillimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë. Programi i studimit ka për qëllim përcjelljen e dijes përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, përgatitjen e specialistëve të lartë me njohuritë bazë dhe programe në fushën e Administrimit Publik, aftësimin e studentëve për tregun e punës si dhe përgatitjen për karrierat e mëtejshme respektive. <i>Evidenca I.9: Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit	Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik”, është një program studimi i ciklit të dytë të studimeve i hartuar në përputhje me rregulloren e institucionit dhe të njësisë kryesore dhe planin strategjik të institucionit, që synon të pajisë studentët me njohuri teorike dhe aftësi të thelluara profesionale në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Programi i studimit është hapur dhe ushtron veprimtarinë që prej vitit 2010 dhe aktualisht është pjesë integrale e Fakultetit Ekonomik. Në përputhje me Statutin, programi i studimit ka për qëllim zhvillimin e dijeve dhe përgatitjen e studentëve në nivel bashkëkohor nëpërmjet aktiviteteve të mësimdhënies dhe aftësimit profesional. Programi i studimit synon të përgatisë specialistë të aftë dhe të kualifikuar në degën e Administrimit Publik, të përshtatshme me standardet europiane dhe kërkesat e grupeve të interesit rajonal duke luajtur një rol të rëndësishëm në ekonominë lokale dhe më gjerë. Evidenca I.20: Akti i hapjes së programit Evidenca I.9: Rregullore e programit të studimit Evidenca I.1: Statuti i UGJ			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit është në përshtatje të nevojave të shoqërisë për specialistë të administratës publike. Ky program mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në lidhje me objektivat strategjike. Në këtë kontekst, në vitin akademik 2018-2019, programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik” u riorganizua nga program i ciklit të dytë me 90 ECTS, në program studimi të ciklit të dytë me 120 ECTS, me kohëzgjatje 2 vite akademike. Përmirësime cilësore i janë bërë programit mësimor përgjatë vitit akademik 2020-2021. Evidenca I.20.1: Miratimi nga MASR i riorganizimit të programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik” Evidenca I.30: SKZHI-II (2015-2020)			
Konkluzione	Programi i studimit ka vite që ofrohet nga IAL dhe është në përputhje të plotë me interesat kombëtare, strategjitë zhvillimore si dhe me profilin dhe objektivat strategjike dhe rregulloret mbi të cilat operon IAL.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit si dhe me strategjinë afatshkurtër dhe afatgjatë të tij duke mbajtur në konsideratë nevojat e tregut të punës dhe duke pasuruar programin mësimor me lëndë të cilat plotësojnë nevojat për këto kërkesa. IAL ka një staf të kualifikuar me tituj dhe grada si dhe me eksperiencë të gjatë akademike dhe profesionale e cila është një vlerë e shtuar dhe e rëndësishme sidomos për një program studimit master profesional. Në tërësi, programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik” është përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit. Objektivat e programit të studimit janë të përshtatura dhe të integruara me strategjinë për zhvillim të institucionit dhe tregut të punës të cilët janë të matshëm dhe të realizueshëm prej tij. <i>Evidenca I.28: CV-të e shkurtuara të personelit akademik të Fakultetit Ekonomik</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik” është pjesë e kurrikulës të Fakultetit Ekonomik dhe përputhet me fushën akademike e kërkimore të kësaj njësie kryesore. Ky program studimi është i organizuar në lëndë mësimore të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është program i nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së. Gjithashtu, nga ana e universitetit është propozuar kodifikimi kombëtar i programit të studimit bazuar në nenin 86 të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” <i>Evidenca I.1: Stauti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë</i> <i>Evidenca I.22: Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve</i>



Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	GVJ konstaton se programi i studimit ofruar nga Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, është një program studimi i Ciklit të Dytë me 120 kredite, i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me formë studimi me kohë të plotë, i ofruar dhe realizuar në gjuhën shqipe, i organizuar me një kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra). Në bazë të shqyrtimit të dokumentave konstatohet që organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje të plotë me fushat e drejtimet akademike të IAL. Objektivat e programit janë në përputhje me objektivat e Fakultetit dhe Departamentit. Evidenca 1.9: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik”			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	N/A			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Universiteti gjatë çdo viti organizon aktivitete të ndryshme profesionale, workshop, diskutime të temave të ndryshme nga lektorë të ftuar nga Universitete brenda dhe jashtë vendit, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit dhe duke i ftuar ata të bëhen pjesë e këtyre aktiviteteve. Evidenca 1.32: Plan i aktiviteteve i NJBAP 2022-2023			
Konkluzione	Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin të cilat kanë gjithashtu kapacitetet e duhura për ta ofruar dhe monitoruar atë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Strategjia dhe drejtimi i fakultetit bazohet në bashkëpunimin midis njësive bazë. Marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit rregullohen përmes Statutit dhe Rregullores së Universitetit dhe janë në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë. Veprimtaria e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër drejtohet e kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese të tij, që veprojnë sipas hierarkisë, me kompetenca të përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë, në statut, në rregullore dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit. Njësia bazë mësimore shkencore, për realizimin e këtij program studimi është Departamenti i Administrimit Publik. Në planin mësimor të këtij program studimi ka lëndë që zhvillohen nga staf i njësive të tjera apo nga stafi i njësive bazë të 2 fakulteteve, Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Fizikës apo nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja. <i>Evidenca I.1: Stauti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i> <i>Evidenca I.29: Tabela e angazhimit të personelit akademik NJBAP 201-2022</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Institucioni ka një sërë marrëveshesh me institucione kombëtare, publike e jo, si dhe profesionale ku studentët mund të ndërmarrin aftësim profesional. Këto marrëveshje shfrytëzohen edhe për të përthithur zërin e tregut të punës dhe për të mundësuar përditësimin e vazhdueshëm të kurrikulës. Përfitues të këtyre marrëveshjeve janë studentët dhe personeli akademik <i>Evidenca I.33: Strategjia e UGJ për ndërkombëtarizim</i> <i>Evidenca I.23: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me	Praktika profesionale në programin e studimit Master Profesional në “Administrim Publik” zhvillohet përgjatë semestrit të dytë të vitit të dytë. Bashkëpunimi i universitetit me bizneset synon krijimin e marrëdhënieve afatgjata dhe të qëndrueshme për

institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	shkëmbim përvoja, kryerjen e praktikave profesionale për studentët, financimin e aktiviteteve të UGJ apo mbështetjen teknike të tyre, ofrimin e shërbimeve kërkimore dhe/ose të konsulencës nga institucioni deri te punësimi i studentëve. Bashkëpunimi i ndërsjelltë ndihmon institucionin të evidentojë nevojat e tregut të punës, si edhe të riorganizojë programin e studimit duke e pasuruar me lëndë të orientuara më tepër drejt praktikës duke mundësuar në këtë mënyrë integrimin më të shpejtë të studentëve në tregun e punës. Evidenca I.23: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia bazë harton në mënyrë periodike raportë të analizës mësimore shkencore, ku në to përfshihet edhe analiza e marrëveshjeve të bashkëpunimit me subjekte të ndryshme shtetërore dhe private. Evidenca I.13: Raport vjetor i NJBAP			
Konkluzione	<i>IAL ka një sërë marrëveshjesh me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat, duke patur parasysh edhe numrin e vogël të studentëve, janë mëse të mjaftueshme për realizimin e komponentit praktik të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Ky program studimi është pjesë e kurrikulës së Fakultetit të Ekonomisë. Programi përputhet me planin afatgjatë dhe afatmesëm të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, në kuadrin e prioriteteve të Integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Ky program është i organizuar në lëndë mësimore të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është i përqëndruar kryesisht në studimin e çështjeve europiane në aspektin e integritit, të drejtën europiane, politikat publike, sistemet politike të Europës si dhe Politikave sektoriale të Bashkimit Europian. Programi i studimit ka një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike me një total prej 120 kredite ku lëndët/modulet vlerësohen sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë. Në tërësi lëndët e programit janë të përshtatshme me qëllimet e programit dhe me objektivat e tij. Gjithashtu lëndët kanë tituj të përshtatshëm, të qartë dhe që përshkruajnë në mënyrë korrekte tematikën e lëndës. Ndarja në kategoritë përkatëse, ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse për çdo semestër, përcaktohen në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij dhe reflektojnë kërkesat e akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Bazuar në planin mësimor dhe kurrikulën e programit të studimit ky program përfshin 15 module me një total prej 93 kreditesh, praktika profesionale 12 kredite dhe mikroteza ka 15 kredite. <i>Evidenca I.4: Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë</i>

	<i>Evidenca I.9: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i> <i>Evidenca II.9.1: Plan Mësimor Master Profesional në “Administrim Publik”</i>
Kriteri 2.Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik” ka si objektiv kryesor formimin e specialistëve dhe ekspertëve në fushën e administrimit publik. Gjithashtu, ky program studimi synon: ➤ përgatitjen e specialistëve të lartë me njohuritë e nevojshme rreth organizimit dhe funksionimit të sektorit publik; ➤ aftësimin e studentëve për tregun e punës dhe ti përgatisë ata për karrierat e mëtejshme respektive; ➤ përgatitjen e specialistëve të aftë në hartimin e politikave publike dhe zbatimin korrekt të tyre; ➤ ofrimin e një mësimdhënie bashkëkohore duke integruar teorinë me praktikën. <i>Nuk ka një studim të mirëfilltë të tregut të punës nga Njësia Bazë e Administrimit Publik lidhur me identifikimin e nevojave dhe kërkesave të tregut të punës lidhur me punësimin e studentëve që diplomohen në këtë program studimi.</i> <i>Evidenca I.9: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i> <i>Evidenca II.9.1: Plan Mësimor Master Profesional në “Administrim Publik”</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Modelet/lëndët janë të ndara sipas kategorive të përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, si vijon: Lëndë bazë të kategorisë A – 12 kredite; Lëndë karakterizuese të kategorisë B – 45 kredite; Lëndë ndërdisiplinore/integruese të kategorisë C – 36 kredite; Lëndë plotësuese të kategorisë D – 12 kredite

	Detyrime përmbyllëse të kategorisë E – 15 kredite <i>Evidenca I.9: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i> <i>Evidenca II.9.1: Plan Mësimor Master Profesional në “Administrim Publik”</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	N / A
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N / A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në	Forma e organizimit të studimeve në programin Master Profesional në “Administrim Publik” është në përshtatje dhe përputhje të plotë me ligjin dhe specifikat e përcaktuara nga ministria e arsimit. Mbështetet në ligjin 80/2015, VKM 41 datë 24.01.2018, e ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 1 datë 14.01.2020, i ndryshuar. Gjithashtu, mbështetet në rregulloren e studimeve në



përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë dhe rregulloret e Fakultetit dhe rregulloren e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik”. <i>Evidenca I.4: Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë</i> <i>Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidenca I.9: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programet e ciklit të dytë të studimit, Master Profesional në Administrim Publik, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi me universitetet publike në Shqipëri kanë përmbajtje të ngjashme (së paku 70 %), janë konsistente dhe ofrojnë një përvojë të ngjashme të mësimit për studentët duke garantuar cilësinë dhe standardet e barabarta për të gjithë studentët në këto programe. <i>Ky ndryshim u bë në bazë të komenteve nga institucioni mbi Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.</i> <i>Shkresa nr.10 Prot. Dt. 22.01.2025. Kthim përgjigje për draftraportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të dytë MP në “Administrim Publik”.</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Institucioni ka realizuar procesin e kodifikimit të programeve të studimit dhe për këtë ka njoftuar Ministrinë me anë të shkresës nr. 343 prot., datë 16.03.2023. Kodifikimi është realizuar bazuar në nenin 86 dhe nenin 125, të ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. <i>Evidenca I.22: përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N / A

Konkluzione	<i>Programi i studimit ofrohet në përputhje me kriteret/kërkesat ligjore si përsa i përket organizimit të programit, ndarjes në ECTS ashtu edhe kriteret e pranimit. Nuk ka një studim të mirëfilltë të tregut të punës nga Njësia Bazë e Administrimit Publik lidhur me identifikimin e nevojave dhe kërkesave të tregut të punës lidhur me punësimin e studentëve që diplomohen në këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti Ekonomik është njësia kryesore e cila koordinon të gjithë veprimtarinë mësimore-profesionale të Administrimit Publik në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë. Fakulteti Ekonomik është hapur me urdhër të MAS nr. 126 atë 20.03.2017, është e organizuar në 3 njësi bazë të cilat janë: 1. Departamenti i Administrimit Publik; 2. Departamenti i Kontabilitet-Financës; 3. Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit; Njësia kryesore dhe njësitë bazë përbërëse të saj kanë staf akademik dhe ndihmës akademik (në sasi dhe në formim me grada e tituj) në përputhje me ligjin 80/2015 dhe aktet nën-ligjore në fuqi. Fakulteti i Ekonomisë si Njësia kryesore që ofron këtë program studimi ka në total për vitin akademik 2022-2023, 32 staf akademik nga të cilët 22 personel akademik efektiv (PAE) nga ku: - 4 kanë titullin “Profesor i Asociuar”; - 13 kanë gradën Dr./PhD; - 5 Asistent Lektorë me Msc; dhe 10 staf akademik me kontratë (PAK) nga ku: - 1 ka titullin “Profesor i Asociuar”;

- 9 Asistent Lektorë me Msc;

Departamenti i Administrimit Publik përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-
Prof. Asoc.	-	1	-	-	1	-
Dr./PhD.	4	-	5	2	5	-
Msc	4	3	2	5	2	3
Totali	8	4	7	7	8	3

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ka marrë akreditim periodik institucional me Vendim Nr. 55, dt. 16.12.2021, të lëshuar nga Këshilli i Akreditimit i ASCAL. Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore.

Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik

Evidenca I.29: Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave

Nga analiza e dokumentacionit GVJ vëren se njësia kryesore dhe ajo bazë përmbushin të gjitha detyrimet ligjore, nga pikpamja sasiore dhe përmbajtësore, për staf akademik me grada dhe tituj.

Evidenca I.16: Organigrama e njësisë bazë

mësimore, laboratorike e klinike, etj.				
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Bazur në RVB si dhe nga vizita në institucion, GVJ vëren se njësia kryesore, me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë për programet master dhe mbikqyrjen e procesit mësimor ka caktuar një koordinator si përfaqësues për ndjekjen e zhvillimeve dhe problematikave të programit të studimit master. Koordinatori kujdeset për realizimin e misionit dhe veprimtarive mësimore të këtyre programeve. Duke qenë që programi ka një numër të kufizuar studentësh aktiv, ky rregullim, sipas GVJ, është i përshtatshëm dhe eficient. Evidenca I.7: Organigrama e njësisë bazë			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për zbatimin dhe mbikqyrjen e programit të studimit përmbushin kriteret ligjore për numrin e stafit me tituj dhe grada si dhe përsa i përket akteve të tjera të brendshme rregullatore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Fakulteti Ekonomik si njësi kryesore dhe Departamenti i Administrimit Publik si njësi bazë që është përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi, disponojnë dokumentacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Specifikisht, FE organizohet në tre njësi bazë, si vijon: Departamenti i Kontabilitet-Financës; Departamenti i Administrimit Publik; Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizimit;

	Veprimtaria e fakultetit dhe e secilit prej departamenteve realizohet duke u mbështetur në aktet e brendshme të IAL dhe rregulloret e njësive bazë, në të cilat pasqyrohen misioni dhe objektivat e secilës. Departamenti i Administrimit Publik përgjegjës për programin e studimit programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore në fushën e administrimit publik. <i>Evidenca I.1: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë</i> <i>Evidenca I.2: Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë</i> <i>Evidenca I.9: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Bazuar në ligjin 80/2015 dhe aktet nën ligjore në fuqi, IAL ofron programe studimi të organizuara në module e të vlerësuara në kredite ECTS, plani mësimor për programin e studimit në shqyrtim pasqyron zhvillimin e programit në 2 vite akademike, 4 semestra, me 120 kredite. Planu përmban informacionet për lëndët/modulet të vlerësuara me kredite sipas sistemit ECTS si dhe siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore ndërmjet semestrave në zbatim të udhëzimeve të MAS (2 semestra me nga 15 javë). <i>Evidenca I.9: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i> <i>Evidenca II.9.1: Plan mësimor Master Profesional në “Administrim Publik”</i> <i>Anekset: Tabelat përmbledhëse (Tabelat 6, Tabela 9, 10,12)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Bazuar në ligjin 80/2015 dhe aktet nën ligjore në fuqi, programin e studimit mund ta ndjekin studentë të cilët zotërojnë së paku diplomën “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS. Procedurat e pranimit përcaktohen në aktet rregullatore të IAL, përfshirë rregulloren e programit të studimit dhe shpallen në të gjitha mjetet e informimit të institucionit. Procedurat e pranimit të studentëve realizohen nga një komision duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga MAS dhe kriteret e veçanta që vendos institucioni. Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet

	rregullatore të IAL dhe shprehet e përmbledhur në një udhëzues të posaçëm. Evidenca II.19: Procedura e transferimit të studentëve Evidenca II.13.1: Kriteret e pranimi të studentëve
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacion mbi njohuritë që ofrohen, e rezultatet e pritshme të mësimnxënies. Specifikisht, në planin mësimor të programit pasqyrohen të gjithë elementët në përputhje me aktet nënligjore në fuqi si: emërtimi i lëndës, semestri kur zhvillohet, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit në ECTS, ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime dhe seanca të praktikave të zhvilluara jashtë auditorit, raporti leksion/seminar, ushtrime, praktika mësimore, mënyra e kontrollit të dijeve si dhe totali i krediteve. Evidenca I.9: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Publik” Evidenca II.9.1: Plan mësimor Master Profesional në “Administrim Publik”
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Çdo fillim viti bëhet rishikimi i lëndëve apo moduleve sipas gruplëndëve të cilat reflektojnë zhvillimet ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ato të shkencës dhe teknologjisë së informacionit. Në syllabuset e lëndëve rishikohen dhe shmangen tema të ngjashme apo të njëjta midis lëndëve. Rekomandohet të rishikohet literatura duke përditësuar dhe përfshirë në tekste apo cikle leksionesh të 5 viteve të fundit. Ndryshimet përkatëse, duhet të bëhen në mbledhjen e departamentit për të marrë miratimin përpara fillimit të vitit të ri akademik. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. Evidenca: Rregullore e Njësisë kryesore FE Evidenca: Rregullore e studimeve UGJ
Konkluzione	<i>Programi është në përputhje me kriteret ligjore, i strukturuar si dhe përmban objektiva formues të qartë e të përshtatshëm për ciklin e studimit. Rekomandohet të rishikohet literatura duke</i>


	<i>përditësuar dhe përfshirë në tekste apo cikle leksionesh të 5(pesë) viteve të fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve të këtij programi studimi, është në përputhje me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit. Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, mundësojnë një thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme të studentëve. Lëndët referuar kurrikulës dhe planit mësimor synojnë formimin e studentit në fushën përkatëse. Objektivi kryesor i këtij program studimi është përgatitja e specialistëve të latë me njohuritë bazë dhe programe në fushat e Administrimit Publik. Programi i lëndëve dhe plani mësimor ofrojnë njohuri bazë teorike si dhe aftësi të pavarura për studime të mëtejshme. Nuk ka një studim të mirëfilltë të tregut të punës nga Njësia Bazë e Administrimit Publik lidhur me identifikimin e nevojave dhe kërkesave të tregut të punës lidhur me punësimin e studentëve që diplomohen në këtë program studimi. <i>Evidenca I.9: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i> <i>Evidenca II.9.1: Plan mësimor Master Profesional në “Administrim Publik”</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e	Programi ka përcaktuar veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët sipas kategorive përcaktëse me ngarkesën përkatëse, të cilat janë në përputhje me Vendimin Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar.

objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi i studimit përmban: - Disiplina bazë formuese përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) gjithsej 12 ECTS; - Disiplina karakterizuese – përgatitje profesionale (B) gjithsej 45 ECTS; - Disiplina ndërdisiplinore/integruese–nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) gjithsej 36 ECTS; - Disiplina plotësuese gjuhë të huaja, njohuri informatike (D) gjithsej 12 ECTS; - Disiplina lëndë plotësuese (E) gjithsej 15 ECTS mikro-teza e diplomës; <i>Evidenca II.9.1: Plan mësimor Master Profesional në “Administrim Publik”</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik” është fokusuar kryesisht në dhënien e njohurive të nevojshme teorike dhe praktike për tregun e punës si dhe karrierat e mëtejshme respektive. Organizimi i programit të studimit është hartuar dhe rishikuar në referencë të programeve të ngjashme kombëtare/ndërkombëtare dhe në bazë të Sistemit European të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, raporti teori praktikë, janë në përputhje me profilin e Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Publik”. Ngarkesa për cdo vit akademik është 60 kredite, një praktikë e njëjtë si me programet e ngjashme ndërkombëtare. <i>Evidenca I.9: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i> <i>Evidenca II.9.1: Plan mësimor Master Profesional në “Administrim Publik”</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,	Shpërndarja e ngarkesës mësimore sipas lëndëve është realizuar me synim që studenti të ketë aftësi për tu përshtatur më shpejt me tregun e punës në përputhje me njohuritë e marra gjatë periudhës së studimeve si dhe zhvillimin drejt një karriere të suksesshme në profesion apo për ndjekjen e studimeve në ciklin e tretë të studimeve. Natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në



mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një lëndë në përmbushje të objektivave formuese të programit. <i>Evidenca I.9: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i> <i>Evidenca II.9.1: Plan mësimor Master Profesional në “Administrim Publik”</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Hartimi i programeve lëndore organizohet nga grupet mësimore kërkimore nën drejtimin e përgjegjësit të grupit mësimor kërkimor, diskutohen dhe miratohen në departament. Titullari i lëndës disponon pranë njësisë bazë programin lëndor (syllabusin) të nënshkruar prej tij. Përpara fillimit të lëndës çdo pedagog ju paraqet studentëve syllabusin e lëndës së bashku me modalitetet e përfshira në të për zhvillimin e mësimi. Pjesë e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literatura bazë e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar. Rekomandohet të rishikohet literatura duke përditësuar dhe përfshirë në tekste apo cikle leksionesh të 5 viteve të fundit <i>Evidenca II.9.1: Plan mësimor Master Profesional në “Administrim Publik”</i> <i>Evidenca I.2: Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi synon t’iu ofrojë studentëve aftësim praktik nëpërmjet mësimdhënies dhe lidhjes me aktorët e tregut të punës dhe u ofron studentëve mundësi jo vetëm të përfitojnë formimin bazë por edhe të kenë mundësi të ndjekin një karrierë të mëtejshme profesionale dhe akademike në përputhje me misionin dhe objektivat e këtij programi. <i>Evidenca I.7: Rregullore e Njësisë Bazë Administrim Publik</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Ky program studimi mundëson vijimin e mëtejshëm të kualifikimit në ciklin e tretë apo edhe në programe apo trajnime licencimi në profesione të rregulluara si Auditues në administratën publike, vlerësues të pavarur të prokurimeve publike, kontabilist të miratur apo ekspertë kontabël. Për këtë ka marrëveshje bashkëpunimi me aktorë dhe partnerë të ndryshëm të sektorit publik. <i>Evidenca I.23: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>

Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit janë në tërësi në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Rekomandohet të rishikohet literatura duke përditësuar dhe përfshirë në tekste apo cikle leksionesh të 5(pesë) viteve të fundit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Universiteti Eqrem Çabej ka shumë bashkëpunime me partnerë, të ndryshëm të sektorit publik dhe atij privat. Po asq e rëndësishme, IAL ka marrëdhënie të strukturuara bashkëpunimi me aktorët e tregut të punës, kryesisht për praktikantë mësimorë dhe për të krijuar lidhje për studentët për të lehtësuar punësimin e tyre të mëtejshëm. Përsa i përket programeve mësimorë, fakultetet dhe njësitë bazë zhvillojnë takime, kryesisht një herë në vit për të identifikuar nevojat e tyre dhe për t'u pëpjekur për t'i reflektuar në sylabuse të cilat 'rifreskohen' në fillim të vitit akademik. Evidenca I.23: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët janë të përfshirë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes së IAL, nga senati deri në njësinë bazë. Ata janë të angazhuar në senatin akademik të institucionit, Këshillin Studentor si dhe kanë statutin e funksionimit të tyre. Evidenca II.1.1: Lista e anëtarëve të Senatit Akademik Evidenca II.24: Statuti i Këshillit Studentor Evidenca II.24.1: Lista e anëtarëve të Këshillit Studentor

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti bashkëpunon me një sërë institucioneve dhe organizata publike (Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastrë, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore Gjirokastrë etj). Pjesëmarrja e stafit akademik në strukturat vendimmarrëse dhe konsultative të këtyre institucioneve dhe organizatave publike, ka bërë të mundur që departamenti të marrë në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve për të përmirësuar përmbajtjen dhe modulet e këtij programi studimi me qëllim rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në tregun e punës. <i>Evidenca II.15: Pjesëmarrja në Panairin Work and Study 2022</i> <i>Evidenca I.24: Lista e projekteve të UGJ</i>			
Konkluzione	<i>IAL ka marrëdhënie të konsoliduara me aktorët e tregut të punës të cilët, ndër të tjera mund të angazhohen edhe në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik” është në përputhje me objektivat dhe mundësitë e institucionit. Njësia bazë e Administrimit Publik ka prioritet që të ofrojë një program studimi me në qendër studentin, për ti përgatitur për një karrierë productive dhe profesionale dhe për të qenë të përgjegjshëm në ofrimin e shërbimeve profesionale me interes publik. <i>Evidenca I.1: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej”</i> <i>Evidenca I.2: Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit,	Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik” përbëhet nga lëndët dhe modulet e tyre të cilat kanë qëllimet,

bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	objektivat, dijet dhe aftësitë profesionale që studentët pritët të përfitojnë në përfundim të studimeve. Programi mbështetet në njohuritë e përfituara në ciklin e parë të studimeve dhe synon përfitim të dijeve, shkathësive e kompetencave praktike në përputhje me nevojat e tregut të punës. Programi synon formimin e shprehive të veçanta nëpërmjet lëndëve bazë, formuese, karakterizuese që synojnë pajisjen e studentëve me njohuri bazë profesionale dhe praktike në studimet politike dhe ndërkombëtare. Pedagogët e lëndëve i ndërtojnë vetë silabuset e tyre në bazë të udhëzimeve ligjore në fuqi e pa kufizime programatike apo përmbajtësore. Ato gjithashtu i përditësojnë ato çdo vit akademik bazuar në zhvillimet akademike dhe reflektimin e kërkesave/mendimeve të studentëve paraardhës. <i>Evidenca I.9: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i> <i>Evidenca I.2: Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej”</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit ka si qëllim tu mundësojë dhe ofrojë studentëve pjesëmarrjen në projekte dhe aktivitete kërkimore dhe shkencore. Studentët kanë bashkëpunuar me pedagogët në realizimin e studimeve apo punimeve për tu paraqitur në konferenca shkencore, si dhe janë pjesëmarrës në të gjitha aktivitetet kulturore, sociale dhe edukative. Gjithashtu studentët janë pjesë e projekteve Erasmus + dhe janë përfshirë në mobilitete të ndryshme. <i>Evidenca I.9: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i> <i>Evidenca I.7: Rregullore e Njesisë Bazë në Administrim Publik</i> <i>Evidenca II.16: Lista e aktiviteteve kulturore, sociale dhe shkencore me pjesëmarrjen e studentëve</i> <i>Evidenca I.25: Lista e mobiliteteve të UGJ</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron	Kërkimi shkencor është në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët. Përfshirja e kufizuar e studentëve në veprimtaritë kërkimore të Njesisë Bazë lidhur me këtë program studimi duhet përmirësuar.

të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.				
Konkluzione	<i>GVJ vëren se programi i studimit është në përputhje me objektivat e institucionit, dhe shkalla e përmbushjes së standardit është e përmbushur plotësisht. Përfshirja e kufizuar e studentëve në veprimtaritë kërkimore të Njesisë Bazë lidhur me këtë program studimi duhet përmirësuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektiveve të programit të studimit në kërkim shkencor.	Njësia përgjegjëse mbështet, nxit dhe respekton grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektiveve të programit të studimit në kërkim shkencor. Gjithashtu mbështet stafin akademik në organizimin e veprimtarive të mësimdhënies, në punën e tyre kërkimore-shkencore, në pjesëmarrjen në studime dhe projekte të ndryshme në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe të huaj si dhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe kualifikimin e tyre. Njësia kryesore dhe njësitë bazë janë të përfshira në disa projekte kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe kanë një sërë marrëveshje me IAL jashtë vendit në kuadër të programeve Erasmus +, që mundësojnë mobilitete të stafit akademik dhe studentëve të këtij fakulteti. Në këtë program studimi, njësia bazë është kujdesur për organizimin e aktiviteteve të përshtatshme që kontribuojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e komunitetit të tij, të akademikëve dhe studentëve. <i>Evidenca I.7: Rregullore e Njesisë Bazë në Administrim Publik</i> <i>Evidenca I.24: Lista e projekteve të UGJ</i> <i>Evidenca I.25: Lista e mobiliteteve të UGJ</i>

Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësia bazë përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. Stafi akademik ka marrë pjesë dhe është angazhuar në projektet kërkimore-shkencore. <i>Evidenca II.29: Përfshirja në trajnime, mobilitete dhe projekte e stafit akademik të FE</i> <i>Evidenca II.16: Lista e aktiviteteve kulturore, sociale dhe shkencore me pjesëmarrjen e studentëve.</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në programin Master Profesional në “Administrim Publik”, njësia bazë është kujdesur për zhvillimin e aktiviteteve të përshtatshme që kontribuojnë në zhvillimin dhe përmirësimin e akademikëve dhe studentëve. Njësia bazë ndihmon në krijimin e një mjedisi të pasur akademik dhe në promovimin e zhvillimit të profesionalizimit, duke inkurajuar dhe suportuar pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve në projekte kërkimore, konferenca shkencore të organizuara nga IAL, si dhe konferenca shkencore të organizuara nga shoqatat studentore. <i>Evidenca I.24: Lista e projekteve të UGJ.</i> <i>Evidenca I.25: Lista e mobiliteteve të UGJ.</i> <i>Evidenca II.16: Lista e aktiviteteve kulturore, sociale dhe shkencore me pjesëmarrjen e studentëve.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Publik” përfshin një kurrikul të pasur me lëndë të specializuara dhe të thelluara që e sjellin studentin në një nivel të lartë të kompetencës në fushën e studimit. Ky program përgatit studentët për sukses në tregun e punës dhe i jep atyre një kompetencë të përshtatshme që mund të aplikohet jo vetëm në nivelin vendas, por dhe në nivel ndërkombëtar. <i>Evidenca I.33: Strategjia e ndërkombëtarizimit të UGJ.</i> <i>Evidenca II.16: Lista e aktiviteteve kulturore, sociale dhe shkencore me pjesëmarrjen e studentëve</i> <i>Evidenca I.23: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e	Programi ka përfshirë kompetencat e nevojshme të licencimit në kurrikulën e tij e cila përmban lëndë dhe aktivitete që zhvillojnë

nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	kompetencat e nevojshme për të marrë licencën e profesionit në administratën publike. <i>Evidenca II.26: Programet lëndore (syllbuset) të programit të studimit MP në “Administrim Publik”</i> <i>Evidenca II.27: Struktura mësimore Master Profesional në “Administrim Publik”</i>			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	N / A			
Konkluzione	GVJ vëren se programi i studimit ofron mundësi për aftësim profesional dhe në këtë kuadër bashkëpunim me tregun e punës. Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të institucionit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe pune, komisione apo në realizimin e detyrave të caktuara akademike dhe administrative në nivel Njësie Bazë, Njësie Kryesore apo në nivel Institucioni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në tërësi, programi i studimit harmonizon metodat e avancuara të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Leksionet bazohen në një diskutim aktiv, punë në grup dhe në projekte individuale që synojnë zhvillimin dhe nxitjen e mendimit kritik si instrument për përmbushjen nga ana e studentëve të objektivave mësimore të programit. Programi i studimit realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Lëndët që ofrohen në këtë program janë të organizuara në kategori të klasifikuara nga A në E. <i>Evidenca II.9.1: Plani mësimor Master Profesional në “Administrim Publik” 2021-2022</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Strategjia e IAL parashikon si prioritet mundësimin e një mjedisi për mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore. Specifikisht, përparësi i jepet zbatimit të metodave dhe metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies. <i>Evidenca I.4: Rregullore e studimeve të UGJ</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	IAL dhe departamenti përkatës mbështesin përhapjen e metodave të suksesshme mësimore ndërmjet stafit akademik, duke synuar rritjen e vazhdueshme profesionale të pedagogëve dhe ofrimin e stimuljeve për përmirësimin profesional. Statuti i UGJ përcakton të drejtën e çdo anëtari të personelit akademik për të marrë pjesë në veprimtari kërkimore shkencore bazë apo të zbatuar, që është në përputhje me objektivin e njësisë bazë ku bën pjesë. Po në statut parashikohet dhe financimi i veprimtarisë kërkimore shkencore sipas kërkesave të njësisë bazë për pjesëmarrje në projekte kërkimore shkencore. <i>Evidenca I.1: Statuti i UGJ, neni 53, 77, 78,79, 80)</i>

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi ka eksperiencën dhe kualifikimin përkatës akademik bazuar në lëndët të cilat zhvillojnë mësimin. Institucioni i jep rëndësi të veçantë procesit dhe kriterëve që aplikon në rekrutimin e personelit akademik. Rregullorja e brendshme parashikon kriterë të përgjithshme të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme. Njësitë bazë respektive përcaktojnë kriterë shtesë të veçanta të rekrutimit. <i>Evidenca I.3: Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025-Rekrutimi i stafit të ri akademik.</i> <i>Evidenca I.2: Rregullore e brendshme e UGJ, neni 27</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia bazë në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera bazë, stafi i të cilave është gjithashtu i angazhuar në këtë program studimi, nxjerr konkluzione mbi efektivitetin e metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike, në varësi të ecures së studentëve dhe përmirëson metodat e mësimdhënies për t’ju përshtatur më mirë studentëve. Kjo realizohet jo vetëm nga diskutimet në njësitë bazë por edhe me studentët gjatë procesit mësimor. <i>Evidenca III.17: Strategjia për mbështetjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse	IAL ka dy struktura bazë për kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies: Senati Akademik dhe Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Këto njësi në bashkëpunim me Njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi, mbështesin përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Në veçanti Njësia Bazë ka rolin kryesor në promovimin dhe mbështetjen e metodave inovative të mësimdhënies. I gjithë stafi i Fakultetit Ekonomik është i përditësuar me zhvillimet e reja në fushat përkatëse, të cilat i reflekton në përmirësime të kurrikulave dhe metodave të mësimdhënies.

mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Evidenca I.1: Statuti i UGJ, Kreu IX Evidenca III.2: Informacion mbi Impact Week: Evidenca 1.24. Lista e projekteve të UGJ. Evidenca 1.25. Lista e mobiliteteve të UGJ.			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni ka njësi dhe politika si dhe rregullore dhe udhëzime dedikuar ngritjes, konsolidimit dhe zbatimit të një sistemi të efikas dedikuar garantimit të formimit akademik e praktik të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve, njohurive si dhe kriteret dhe komponentët e vlerësimit pasqyrohen në plan programet e çdo lënde. Në rregullore përcaktohet vlerësimi dhe kontrolli i dijeve i ndarë në dy pjesë: vlerësim i vazhduar (20% të vlerësimit total) dhe vlerësimi në provimin final (80% të vlerësimit total). Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik Evidenca I.7: Rregullore e Njesisë Bazë Evidenca I.9: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik”
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e	Në fillim të çdo lënde, studentët informohen mbi programin e plotë të lëndës dhe të gjithë elementët përbërës të tij nga titullari i lëndës dhe syllabuset përcaktojnë në mënyrë të detajuar struktura specifike të vlerësimit të secilës lëndë. Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik

shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Evidenca I.7: Rregullore e Njesisë Bazë Evidenca I.9: Rregullore e programit të studimit MP në “Administrim Publik”			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Duke reflektuar kërkesat e Rregullores së Programit të studimit, në syllabuset e lëndëve janë parashikuar format dhe masa e vlerësimit të çdo komponenti. Kryesisht, testimi i njohurive dhe shkathtësive realizohet nëpërmjet provimeve të ndërmjetme, përfundimtare, detyrave të shtëpisë, të kursit, ushtrimeve, etj. Testimet mund të zhvillohen me shkrim ose me gojë në varësi të specifikave të lëndëve. Tërësia e metodave të mësipërme siguron një vlerësim të vazhdueshëm, gjithëpërfshirë dhe jo penalizues për studentët. Konvertimi i pikëve të marra nga vlerësimet, në notë, përcaktohet në syllabus (20% frekuentimi, aktivizimi dhe niveli i diskutimit në seminare, punë individuale dhe në grup dhe 80% provimi përfundimtar me shkrim) Evidenca I.4: Rregullore e Studimeve në UGJ Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik Evidenca I.7: Rregullore e Njesisë Bazë Evidenca I.9: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik”			
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni ka procedura të qarta, të përshtatshme e gjithëpërfshirëse për vlerësimin e dijeve dhe shkathtësive të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe	Kontrolli i dijeve për çdo lëndë është i vazhdueshëm, kjo me qëllim mbajtjen angazhuar të studentit gjatë gjithë zhvillimit të

aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	lëndës. Konvertimi i pikëve të marra nga vlerësimet, në notë, përcaktohet në syllabus (20% frekuentimi, aktivizimi dhe niveli i diskutimit në seminare, punë individuale dhe në grup dhe 80% provimi përfundimtar me shkrim). Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik, neni 32 Evidenca II.26: Programet lëndore të programit të studimit Master Profesional në "Administrim Publik"
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Më datë 12 shkurt 2020 është firmosur marrëveshja e bashkëpunimit midis Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër për zbatimin e projektit Clean Score. Kjo ka mundësuar rritjen e transparencës dhe të besueshmërisë. Në të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program, provimi zhvillohet nga 2 (dy) pedagogë, si rrjedhojë edhe komisionet që testojnë studnetët përbëhen nga 2 (dy) pedagogë, njëri prej të cilëve është titullari i lëndës. Evidenca I.4: Rregullore e Studimeve në UGJ Evidenca III.8: Marrëveshje Bashkëpunimi AADF-UGJ
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Studentët merren në provim nga një komision i përbërë nga 2 pedagogë. Teza hartohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë. Evidenca I.2: Rregullore e UGJ, kreu VII
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i provimeve shoqërohet me komente për të ndihmuar studentin të kuptojë se sa ka përvetësuar nga lënda dhe çfarë duhet të përmirësojë në të ardhmen. Në provimin final pedagogu ose pedagogët duhet të argumentojnë notën që i vihet studentit. Teza e provimit me shkrim vlerësohet me 80 pikë, ku për çdo pyetje/ushtrim vihen pikët përkatëse, në varësi të pyetjes/ushtrimit. Vlerësimi me pikë shënohet në fletën e provimit dhe në formatin për,bledhës të vlerësimit të studentëve, i cili firmoset nga 2 (dy) pedagogët, anëtarë të komisionit. Evidenca I.4: Rregullore e Studimeve në UGJ
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë	Studentët, janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e Kodit të Etikës së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit, përfshirë dhe dispozitat që parashikojnë sjelljen e tyre (mos kopjimi, mos mashtrimi, si dhe

plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	plagjiaturat e çdo forme). Pedagogët e çdo lënde janë të kujdesshëm për të shmangur veprimet e sipërcituara. Evidenca I.2: Rregullore e UGJ Evidenca III.10: Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Vlerësimi i studentëve bazohet mbi meritën e studentit dhe jepet në kohën e caktuar. Pasqyra e rezultateve të provimit dorëzohet në sekretari brenda 2 (dy) ditëve nga data e zhvillimit të provimit. Deri 8 (tetë) ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretarinë mësimore rezultatet përfundimtare të provimit. Evidenca I.2: Rregullore e UGJ Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët njihen me notën përpara se kjo të dorëzohet në sekretari dhe mund të kërkojnë të takohen me pedagogun për të marrë një arsyetim lidhur me vlerësimin. Studentët kanë të drejtën e ankimit për notën brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e përgjigjes së provimit pranë pedagogut të lëndës, i cili shqyrton nëse ka patur ndonjë gabim në korrigjimin e provimit, dhe në rast se studenti nuk bindet ka të drejtë të ankohet pranë dekanatit që ngre një komision vlerësimi. Studentët ndjekin një procedurë të veçantë për ankimimet në të gjitha nivelet dhe për të gjitha strukturat duke përfshirë si anën akademike ashtu edhe atë administrative. Tezat dhe fletoret e provimeve të studentëve ruhen nga pedagogu deri në përfundim të afatit të ankimit. Evidenca I.4: Rregullore e studimeve në UGJ
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studentët kanë të drejtë të ankimojnë notën fillimisht me pedagogun e lëndës dhe nëse pedagogu nuk e gjykon me vend ta rishikojë, atëherë ai i drejtohet me shkrim Dekanit të Fakultetit Ekonomik, brenda afatit të ankimit. Shqyrtimi i ankimit kryhet nga Dekani i Fakultetit Ekonomik, i cili përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo. Ai merr vendimin brenda 2 (dy) ditësh dhe ky vendim është i formës së prerë. Evidenca I.2: Rregullore e UGJ

	Evidenca I.4: Rregullore e studimeve në UGJ			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se procesi i vlerësimit është i mirë-rregulluar, transparent, me nivele të ndryshme dhe të përshtatshme kontrolli, që ofrojnë mundësinë për një vlerësim të drejtë të dijeve dhe shkathtësive studentore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit është në përputhje me kornizën Shqiptare të kualifikimeve në lidhje me njohuritë që ofron përmes leksioneve, seminareve e praktikave. Gjatë 1 viti akademik zhvillohen 6 lëndë/module, praktika dhe mikro teza për të cilat metoda e mësimi dhe vlerësimit është nëpërmjet leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, projekteve, etj. Programi i studimit jep një sistem të gjerë njohurish në fushën e kontabilitetit publik, auditimit, administrimit fiskal, lidhshirë etj. Për realizimin e objektivave, programi i studimit parashikon thellimin e njohurive në fushat bazë të tilla si: planifikim strategjik në sektorin publik, komunikim dhe marrëdhënia e publikun, etika në administratën publike, e drejta publike me të cilat studenti është njohur dhe ka fituar njohuritë themelore në programin e ciklit të parë. Evidenca II.9.1: Plani mësimor Master Profesional në “Administrim Publik” Evidenca II.26: Syllabuset e programit të studimit
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe	Në vitin e parë të studimeve, pjesë e programit janë lëndë që zhvillojnë aftësinë e studentëve mbi drejtimin e shpërbërimit, menaxhimin e projekteve, auditim në sektorin publik, sistemet e informacionit të menaxhimit, të cilat i pajisin studentët me njohuri bazë për të analizuar vendimet ekonomiko – financiare të institucioneve buxhetore, analizuar dhe projektuar sistemet e

ndërveprimet (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	informacionit. Në vitin e dytë studentët zhvillojnë lëndë të cilat i mësojnë atyre bazat e planifikimit strategjik, dimensionet e ndryshme të zhvillimit të strategjisë, sistemit tatimor, legjislacionit tatimor, administrimin dhe procedurat tatimore, llojet e ndryshme të tatimeve dhe taksave që aplikohen në Shqipëri. Evidenca II.9.1: Plani mësimor Master Profesional në “Administrim Publik” Evidenca II.26: Syllabuset e programit të studimit
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në fillim të çdo semestri, studentët prezantohen me lëndët përkatëse dhe informohen nga pedagogu i lëndës mbi programin e plotë të lëndës, objektivat kompetencat dhe aftësitë që pritet të fitojë studenti përgjatë gjithë semestrit të cilat gjithashtu janë pjesë edhe e hartimit të syllabuseve. Evidenca II.9.1: Plani mësimor Master Profesional në “Administrim Publik” Evidenca II.26: Syllabuset e programit të studimit
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e	Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që tju japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në praktikën profesionale. Stafi akademik në varësi edhe të natyrës së lëndës, nxit studentët në hartimin e planeve të biznesit, apo shkrimin e projekteve duke mbështetur çdo ide të tyre dhe duke mundësuar kthimin e idesë në projekt apo plan konkret biznesi. Këto plane biznesi/projekte prezantohen përpara studentëve të tjerë. Stafi akademik nxit dhe mbështet diskutimet dhe punën në grup pasi kjo është një mënyrë shumë e mirë për t’i mbajtur studentët të aktivizuar gjatë orës së mësimi. Në faqën zyrtare të UGJ vazhdimisht publikohen njoftime/thirrje për studentët e interesuar në pjesëmarrje në konkurse, aplikime për fitimin e bursave të studimit, shkolla verore/dimërore apo programe Erasmus +. Në strategjinë e zhvillimit të UGJ si objektivi i kërkimit shkencor renditet dhe mbështetja financiare për

mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	përfshirje gjithnjë e më të gjerë në projektet kërkimore-shkencore jo vetëm e stafit akademik por edhe e studentëve. Evidenca I.3: Strategjia e zhvillimit të UGJ Evidenca I.25: Lista e mobiliteteve të UGJ Evidenca I.24: Lista e projeteve të UGJ			
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik është i organizuar në vazhdimësi në veprimtari shkencore jashtë programit të studimit dhe për këtë qëllim organizon orë të hapura me të ftuar edhe inkurajon studentët që të marrin pjesë në takimet e organizuara nga stafi duke paraqitur mundësinë e zgjerimit të njohurive që i takojnë programit të studimit që studentët ndjekin dhe jo vetëm. Evidenca III.15-III.15.2: Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UGJ ndjek një politikë mbështetëse të ideve inovative, projekteve kërkimore të studentëve dhe i mbështet financiarisht ato. Në strategjinë e zhvillimit të UGJ si objektivi i kërkimit shkencor midis të tjerave renditet edhe mbështetja financiare për përfshirje gjithnjë e më të gjerë në projektet kërkimore-shkencore jo vetëm e stafit akademik por edhe e studentëve. Evidenca I.3: Strategjia e Zhvillimit të UGJ			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se natyra ndërdisiplinore dhe empirike e programit të studimit i mundëson studentëve krijimin dhe testimin e shkathtësive praktike të nevojshme për integrim në tregun e punës</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Rregullorja e Fakultetit përcakton procedurat që ndiqen lidhur me detyrimet përmbyllëse. Në përfundim të programit të studimit, studentët i nënshtrohen provimit përfundimtar / punimit të diplomës. Në rregullore është i përcaktuar gjithashtu pragu i notës mesatare që i jep studentit të drejtë të futet në provim diplome. Këto procedura janë të parashikuara gjithashtu dhe në rregullore e programit të studimit. <i>Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidenca I.2: Rregullore e UGJ</i> <i>Evidenca I.9: Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Administrim Publik"</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Çdo pedagog i caktuar si mbikqyrës i tezës punon me studentit duke e udhëzuar për forminin e argumentit dhe materialet e që duhet të konsultojë studentin. Pedagogët i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Ky informacion përfshin si detyrimet akademike ashtu edhe ato financiare që studentët kanë për përmbylljen e programit. Njësia bazë në fillim të vitit të dytë, vë në dispozicion të studentëve programin përkatës me tema orientuese që ata të mund të zgjedhin për të përgatitur temën e diplomës brenda tematikave të lëndëve që kanë ndjekur në këtë program studimi. Kjo listë miratohet me vendim të dekanit të Fakultetit Ekonomik dhe bazohet në fushat e studimit që mbulon njësia bazë. <i>Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidenca III.11: Listë me tema të përgjithshme për diplomim Master Profesional</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi i përgjithshëm ose mbrojtja e temës së diplomës realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik të njësisë bazë, të fushave që mbulon programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar. Anëtarët e komisionit propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga dekani i fakultetit. Provimi i përgjithshëm përfundimtar hartohet nga personeli i njësisë bazë të administrimit publik, miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe dekani i fakultetit. Tezat e provimit firmosen nga përgjegjësi i departamentit dhe

	miratohen nga dekani. Provimi përfundimtar zhvillohet me gojë. Evidenca I.4: Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evidenca III.11.2: Model i unifikuar i tezës së provimeve Evidenca III.5: Propozim i përgjegjës të njësisë bazë për ngritjen e komisionit të diplomës
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Në rastin kur studenti plotëson kriterin e notës mesatare të mbrojtjes së provimit të formimit me temë diplome, si në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës përcakton temën e diplomës. Ky përcaktim bëhet në fillim të semestrit të katërt në mënyrë që studenti të fillojë punën për hartimin e draftit të dizertacionit. Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës. Evidenca I.4: Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evidenca III.11.1: Manuali i punimit të diplomës Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Udhëheqësit i asistojnë studentët në të gjitha hapat e përgatitjes dhe punimit. Përveç vendosjes në dispozicion të studentit të të gjithë bazës së nevojshme materiale brenda institucionit, udhëheqësi ofron gjithashtu nëpërmjet kontakteve edhe mundësinë që studenti të marrë ekspertizën dhe ndihmen e nevojshme me ekspertë jashtë institucionit kur kjo është e nevojshme.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë dhe nëse nota është kaluese, ai fiton 15 kredite, referuar planit mësimor. Vlerësimi i notës pasqyrohet në procersverbalin përkatës, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit. Evidenca I.4: Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

	<i>Evidenca III.11.1: Manuali i punimit të diplomës</i> <i>Evidenca II.9.1: Plani mësimor</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në rregulloren e institucionit ofrohen udhëzime për pajisjen e studentit me diplomën e Masterit. Në përfundimin e suksesshëm të programit të gjithë studentët pajisen me diplomën përkatëse shoqëruar me fletën e notave dhe suplementin e diplomës. Forma dhe përmbajtja e këtyre dokumentave janë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit si dhe Qendra Kombëtare e Shërbimit të Studentëve (QSHA), dhe rregjistrohen pranë Zyrës së Rregjistrimit, ndërsa dorëzimi i tyre bëhet në një ceremoni të veçantë. <i>Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidenca I.2: Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i> <i>Evidenca II.5.1: Modeli suplementi i diplomës Master Profesional në “Administrim Publik”</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria Mësimore ka si detyrë mbajtjen e regjistrimit themeltar me të dhënat e studentëve, si në formën fizike ashtu edhe në atë elektronike. Studentët, në mbyllje të studimeve kanë të drejtë të tërheqin dokumentacionin personal. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucioni kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Dokumentacioni i administruar është si më poshtë: Regjistri themeltar i studentëve; Regjisti i arritjeve akademike; Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave. <i>Evidenca I.1: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i> <i>Evidenca III.13: Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidenca 5: Rregullore e njësisë kryesore Fakulteti Ekonomik</i>
Konkluzione	<i>Procedurat dhe detyrimet e diplomimit janë të qarta dhe publike. Institucioni ka mekanizmat dhe burimet e duhura për</i>

	të mundësuar një tutorat efektiv studentëve në përmbushje të detyrimeve përmbyllëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Në programin e studimit Master Profesional në “Administrim Publik” ofrohet praktika profesionale në fund të semestrit të IV. Për realizimin e praktikës, universiteti ka një bashkëpunim të gjerë me institucionet e administratës publike për të realizuar praktikatat mësimore në përputhje dhe me objektivat specifike që ka program i praktikës. Kjo praktikë realizohet në fund të programit të studimit, siç është pasqyruar në planin mësimor. Studentëve i vihet në dispozicion lista e institucioneve me të cilët IAL ka marrëveshje për praktikën profesionale nga ku zgjedhin. Praktika ndiqet nga një pedagog i dedikuar për këtë proces i cili sigurohet që procesi të vijojë me sukses. <i>Evidenca I.23: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky standard nuk është i aplikueshëm pasi në këtë program studimi nuk aplikohen praktika klinike dhe stazhe, por vetëm praktika profesionale.



Kriteri 3. Praktik profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Në përfundim të praktikës profesionale, student bën mbrojtjen e saj para një komisioni prej 2 pedagogësh duke paraqitur një listë me dokumenta si dhe vërtetimin përkatës lëshuar nga titullari/administratori i institucionit public ku ai ka realizuar praktikën, të cilat shqyrtohen dhe student vlerësohet me notë, e cila kur është kaluese i korrespondon 12 krediteve të planit mësimor. <i>Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i> <i>Evidenca II.9.1: Plan mësimor Master Profesional në "Administrim Publik"</i>			
Konkluzione	GVJ konkludon se institucioni mundëson praktien profesionale nëpërmjet marrëdhënieve me partnerët e jashtëm dhe të tregut të punës duke rritur mundësitë që studentët të integrohen suksesshëm në tregun e punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës	Mënyra e organizimit të njësisë bazë të Administrimit Publik dhe struktura hierarkike e saj janë në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të përcaktuara. Personeli akademik

akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	dhe ndihmës akademik që angazhohen në realizimin e këtij program studimi përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Për sa i takon personelit akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi, <i>GVJ ju referua Tabelës 12 për të marrë të dhëna për stafin mësimdhënës në këtë program studimi</i>. Referuar tab 12.1-12.3 stafi mësimdhënës për këtë program studimi për tre vite akademike është si vijon: <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2020-2021</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>12</td><td>-</td><td>13</td><td>1</td><td>12</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Totali</td><td>12</td><td>1</td><td>13</td><td>1</td><td>13</td><td>0</td></tr></table> Niveli i kualifikimit të personelit akademik që mbulon programin e studimit Master Profesional në “Administrim Publik” është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçoritë e lëndëve të tij.	Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-	Prof. Asoc.	-	1	-	-	1	-	Dr./PhD.	12	-	13	1	12	-	Msc.	-	-	-	-	-	-	Totali	12	1	13	1	13	0
Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-																																											
Prof. Asoc.	-	1	-	-	1	-																																											
Dr./PhD.	12	-	13	1	12	-																																											
Msc.	-	-	-	-	-	-																																											
Totali	12	1	13	1	13	0																																											
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi bazuar në ligjin 80/2015. Nga sa më sipër rezulton që për të tre vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi bachelor, është përballuar 92% - 100 %, nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. <i>Anekset (Tabelat 1-24) Master Profesional në “Administrim Publik”, Tabelat 12.</i>																																																
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e	Bazuar në analizën e GVB, Institucioni garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit për të gjithë periudhën e akreditimit, duke																																																

personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Bazuar në analizën e GVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se procedura e rekrutimit është e mirë-rregulluar dhe e njohur për të gjithë aktorët e institucionit. NJBAP, bazuar në nevojat e saj përcakton kriteret e përgjithshme dhe specifike të punësimit të personelit akademik në përputhje me natyrën, strukturën, lëndët mësimore dhe përmbajtjen e programit të studimit. Dekani, pasi i verifikon dhe është dakord me to, i përcjell për miratim në Rektorat për ndjekje dhe shpallje në Buletinën e Prokurimeve Publike si dhe në faqen zyrtare të ueb të Universitetit. Pas miratimit të kriterëve dhe shpalljes, me urdhër ngrihet komisioni “ad-hoc” për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për vendin vakant me 5 anëtarë, i përbërë nga Dekani i fakultetit i cili kryeson komisionin, 3 anëtarë pjesë e personelit akademik të njësisë bazë përkatëse dhe 1 anëtar nga rektori. Evidenca I.1: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evidenca I.2: Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në analizën e GVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, siç u shprehëm edhe më sipër, ka angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi. Këto burime njerëzore përmbushin kriteret ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Specifikisht, për këtë program studimi, nuk ka nevojë për personel ndihmës akademik për orë laboratorike.

Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Nga vizita në institucion dhe specifikisht në zyrën e burimeve njerëzore dhe sekretarinë mësimore, GVJ u njoh nga afër me mënyrën se si ruhej dokumentacioni për këtë program studimi. GVJ vuri re se informacioni në lidhje me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi, për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Gjatë vizitës në institucion GVJ nuk evidentoi mangësi në dosjet e personelit akademik. <i>Evidenca I.1: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i> <i>Evidenca I.2: Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Në planin mësimor që mbulon programin e studimit Master Profesional në “Administrim Publik” janë planifikuar të zhvillohen orë mësimore të praktikës profesionale. Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me anëtarë dhe partnerë të ndryshëm të sektorit publik për realizimin e praktikave profesionale dhe temave të diplomës si dhe orëve të tjera praktike. Njësia bazë e Administrimit Publik bashkëpunon me një sërë institucioneve dhe organizata publike, duke vënë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në realizimin e praktikave profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. Në fillim të vitit të fundit të studimeve përcaktohen fushat e studimeve për punimin e diplomës. Udhëheqësi i temës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollon punën sipas programit të miratuar. <i>Evidenca I.4: Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër.</i>
Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave	Lënda e praktikës profesionale mbikqyret nga një lektor i dedikuar i cili, në bashkëpunim me institucionin pritës, bën vlerësimin tërësor me notë për praktikën profesionale. Praktika mund të zhvillohet në një nga institucionet me të cilat IAL ka



profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	marrëveshje ose diku tjetër në varësi të interesit të studentit dhe me miratimin e pedagogut përkatës.			
Konkluzione	<i>Për realizimin e programit të studimit MP në "Administrim Publik", IAL ka angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë, që zotërojnë tituj dhe grada shkencore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Planit mësimor dhe Cv të stafit akademik, GVJ kostaton se formimi profesional i pedagogëve përputhet me lëndët që ata zhvillojnë në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Auditorët e FE janë të pajisur me teknologjinë e duhur për të lehtësuar aktivitetet e punës në grup, diskutimet dhe simulimet e rasteve studimore, ndërsa sallat e laboratorëve si dhe vendosja e projektorëve dhe pajisjeve kompjuterike, mbulimi me ëi fi. Në mjediset e fakultetit janë një mbështetje mjaft solide për stafin akademik dhe studentët. Mbështetja e procesit të mësimdhënies nga sistemi TEAMS, edhe jashtë auditorëve, mundëson përdorimin e mjeteve të reja të dobishme për mësimdhënien dhe mësimin elektornik. Institucioni ushtron aktivitetin akademik në 3 godina universitare. Këto janë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore të cilat plotësojnë kushtet higjieno sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ. Godinat plotësojnë standardet teknike dhe ofrojnë akustikë të mirë dhe janë të izoluara nga zhurmat, luhatjet e temperaturës

	dhe lagështirës. Ka sistem mbrojtës të shkarkesave atmosferike si dhe sistem kundra zjarrit. Evidenca IV.9: Infrastruktura e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evidenca IV.10: Leja higjeno sanitare Evidenca IV.11: Çertifikatë për sigurinë nga zjarri
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ambientet mësimore të IAL ishin të përshtatshme pasi ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor. Laboratorët e IT kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e punës kërkimore.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka laboratorë të pajisur me programe profesionale në përputhje me tipologjinë e programeve të studimit që ofron. Shfrytëzimi i laboreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve. Specifikisht, ky program studimi nuk ka nevojë për laboratorë specifikë apo të dedikuar.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas	Nga analiza e RVB dhe nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ambientet mësimore të IAL ishin të përshtatshme pasi ishin të pajisura, ndër të tjera, me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti Wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor. Laboratorët e IT kanë poste të pajisura me PC

natyrës së programit të studimit që ofron.	dhe programet përkatëse të nevojshme për zhvillimin e punës kërkimore. Fakulteti Ekonomik disponon 3 (tre) laboratorë të Informatikës.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	Nga analiza e RVB dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ambientet në dispozicion të këtij programi studimi janë mëse të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Për më tepër, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte biznesi të cilat mundësojnë punësimin potencial të studentëve.			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni disponon mjediset mësimore dhe infrastrukturën mbështetëse në dispozicion të programit të studimit për të mundësuar formimin teorik dhe shkathtësimin praktik të studentëve.</i> <i>Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë bashkëkohore me standarde dhe të pajisura me logjistikën përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga analiza e RVB dhe nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se literatura në gjuhën angleze dhe shqipe në dispozicion të studentëve është e bollshme dhe e përshtatshme. Duke ju referuar syllabuesëve të lëndëve, GVJ konstatoi se lëndët referojnë literaturë të bollshme dhe kryesisht bashkëkohore me tekste mësimore të autorëve më të njohur dhe ekspertëve ndërkombëtarë më në zë të fushës.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Të gjithë pedagogët e Njesisë Bazë të Administrimit Publik bëjnë vazhdimisht përditësime të materialeve të tyre didaktike. NJBAP, përpara miratimit të buxhetit vjetor institucional, paraqet propozimin e tij për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. Propozimet miratohen sipas procedurave përkatëse të Institucionit. <i>Evidenca IV.12: Raportime nga biblioteka për departamentin</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik, në mbështetje të procesit mësimor dhe formimit të tyre profesional, Bibliotekën Akadematike e cila ndodhet në Godinën C të Universitetit. Biblioteka disponon tre salla leximi, të cilat janë të pajisura me kompjutera dhe me mjete audio vizive. Biblioteka disponon fond librash në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha	Sipas raportimeve të paraqitura në RVB, biblioteka e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, është e pajisur me fond fizik si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, e mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjithë moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik” dhe degëve të tjera. <i>Evidenca III.9: Informacion për bibliotekën U-Library</i>

moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UGJ në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, ka mundësuar për stafin akademik dhe studentët shërbimin “on-line” të Bibliotekës “U-Library”. Në faqen zyrtare web të UGJ-së, personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë “on-line” literaturë të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit duke ndjekur udhëzimet e manualit përkatës. Ky shërbim ofrohet pa pagesë për studentët dhe personelin akademik. <i>Evidenca IV.14: Biblioteka, Manuali i përdorimit</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët për kërkimin e literaturës qoftë për t’u përdorur përgjatë studimit qoftë për të realizuar temat e diplomës. <i>Evidenca III.9: Informacion për bibliotekën U-Library</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ofron shërbim prej punonjësve të saj për studentët dhe personelin akademik ditët e javës, e hënë – e premte, në orarin 8:00-19:00, në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, në përgjigje të nevojave, numrit të studentëve dhe kapaciteteve të saj. Orari është i afishuar në mjediset e institucionit dhe në hyrje të Bibliotekës. <i>Evidenca IV.14.1: Rregullore e Bibliotekës</i> <i>Evidenca IV.13: Biblioteka, kartelë personale e përdoruesit</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e	Biblioteka ndjek dhe raporton mbi cilësinë e fondit fizik të saj dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah efektshmërinë e përpjekjeve për pasurim të fondit fizik dhe atij online. <i>Evidenca IV.12: Raportime nga biblioteka për FE</i> <i>Evidenca III.9: Informacion për bibliotekën U-Library</i>

shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.				
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni disponon literaturën e nevojshme dhe mjediset mbështetëse për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Biblioteka në UGJ siguron literaturë fizike dhe digjitale/ on line ku, studentë tmund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga analiza e RVB, evidentohet se UGJ është pjesë e RASH dhe QSHA. Nëpërmjet këtyre platformave realizohet aplikimi dhe regjistrimi on line i kandidatëve në programet e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, si dhe matrikullimi bazuar në të dhënat e detajuara të përcjalla nga Universiteti. Në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, statutin dhe rregulloren e sekretarisë mësimore, sekretaritë administrojnë: Regjistrin themeltar të studentëve; Regjistrin e arritjeve akademike; Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.

	Institucioni disponon sistemin elektronik Pitagora, aplikacion softuerik i sekretarisë online i zhvilluar nga RASH, që ofron funksionalitete për administratën, sekretarinë dhe përdoruesit fundor (studentë, pedagogë).
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Menaxhimi i dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ realizohet nga Drejtoria e shërbimeve Ndihmës Akademike – Administrative, nëpërmjet sektorit të shërbimeve juridike, personelit dhe sekretari protokoll, të cilat menaxhojnë: regjistrin themeltar, dosjet personale të punonjësve, librezat e punës së punonjësve dhe çdo dokumentacion tjetër të dhënë nga rektori apo administratori i Universitetit. Evidenca IV.6: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA Sektori i kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë administron dhe përditëson bazën e të dhënave të kërkimit shkencor të personelit akademik dhe kërkimor. Bazuar në rregulloren e fakultetit ekonomik, NJBAP ruan me kujdes dokumentacionin përkatës në lidhje me personelin akademik (ngarkesën mësimore vjetore, marrëveshjet e realizimit të kohës vjetore të punës, programet lëndore etj). Evidenca IV.7: Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik Evidenca I.5: Rregullore e Fakultetit Ekonomik
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni nëpërmjet sistemit elektronik Pitagora, siguron akses të dedikuar dhe konfidencial në informacione dhe dokumente, të gjithë personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve të programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik”. Personeli akademik dhe ndihmës akademik ka akses në llogaritë e tyre ku shfaqen të dhënat mbi lëndët mësimore, sezonet e provimeve, orët e tyre, lista e studentëve të regjistruar, procerverbale provimi etj. Studentët mund të aksesojnë informacion dhe të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që frekuentojnë dhe vlerësimet e çdo lënde. Informacion në lidhje me programin e studimit si: rregullore mësimore, plan mësimor, struktura mësimore, oraret mësimore janë të publikuara dhe në faqen zyrtare të institucionit.

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nga analiza e RVB, format e komunikimit përfshijnë përvç faqes ueb dhe postës elektronike zyrtare edhe platformat elektronike si: Microsoft Office 365, Microsoft Teams etj. Këto janë përdorur si për zhvillimin e leksioneve virtuale përgjatë pandemisë, po ashtu dhe për komunikim në distancë ndërmjet stafit akademik dhe studentëve. Gjithashtu, në kuadër të projektit Erasmus plus, është pilotuar edhe platforma elektronike "Learning Key".			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nga analiza e RVB evidentohet se platformat elektronike garantojnë monitorim në kohë reale dhe vazhdimisht të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Sipas nevojave, këto sisteme mundësojnë raportime individuale mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit, monitorimin dhe afatet e hedhjes së vlerësimeve nga ana e personelit akademik etj. Në aspektin administrativ, institucion ka instaluar kamera dhe sisteme sigurie për të garantuar në kohë sigurinë dhe kujdesin e shërbimeve të ofruara. <i>Evidenca VI.4: Rregullore e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i>			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik të përfshirë në të, aktivitetet e ndryshme të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, gjenden në faqen e ëeb-it të institucionit. Në tërësi, GVJ konstatoi se informacionet online në lidhje me programin e studimit ishin të plota dhe të dobishme si për studentët aktual ashtu edhe për ata potencial. Informacionet janë në gjuhën shqipe dhe angleze.			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit i cili është efektiv dhe mundëson një ndërveprim më të zhdërvjellët midis studentëve dhe institucionit në funksion të mësimdhënies e mësimnxënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se IAL përcakton në Statut pikat që lidhen me buxhetin dhe aspektet financiare të institucionit ku identifikohen aktorët dhe proceset Specifikisht, bazuar në RVB dhe statut, buxheti hartohet nga administratori i universitetit mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillit të universitetit, planin buxhetor afatmesëm dhe miratohet nga Bordi i administrimit me propozim të Senatit Akademik. Pas miratimit buxheti i detajuar kalon për menaxhim në Drejtorinë e Shërbimeve Universitare dhe delegohet në varësi të kërkesave apo nevojave të njësive.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në	Rekomandohet një administrim më efektiv i buxhetit nga Njësia Bazë e AP, për të mundësuar identifikimin dhe adresimin e nevojave konkrete, si për stafin akademik, ashtu edhe për studentët e këtij programi studimi. Plani i financimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shërbimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, për pasurimin e literaturës së saj si dhe aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. <i>Evidenca IV.16.1-IV.16.3: Raporti vjetor financiar</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Bazuar në RVB kjo gjë ndodh rregullisht. Gjithsesi, GVJ nuk ka aftësitë teknike për ta vlerësuar diçka të tillë. Duke qenë një subjekt tregëtar i cili e ka për detyrim ta kryej auditim, GVJ beson që ai kryet sipas kërkesave ligjore në fuqi.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për	Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se kontrolli buxhetor realizohet nga administratori dhe synon përdorimin efikas të

programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	burimeve të institucionit, në funksion të arritjes së objektivave. Sipas DVV, detyrë e administratorit është ndjekja dhe zbatimi i buxhetit vjetor dhe paraqitja në përfundim të cdo viti akademik para Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik të raportit të veprimtarisë financiare. Bazuar në analizën e DVV, GVJ kosntaton se institucioni ka paraqitur një plan financiar institucional të krahasuar kundrejt buxhetit faktit. Evidenca IV.16.3. Raporti vjetor financiar për vitin 2022			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, burimet e financimit të institucionit publik të arsimit të lartë janë 2: financim nga buxheti i shtetit dhe financim nga të ardhurat dytësore të cilat sigurohen nëpërmjet studentëve. Evidenca IV.16.1-IV.16.3: Raporti vjetor financiar			
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni ka burimet financiare si dhe procedurat përkatëse të institucionalizuara në statut për financimin e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve <u>Rekomandohet</u> një administrim më efektiv i buxhetit nga Njësia Bazë e Administrimit Publik, për të mundësuar identifikimin dhe adresimin e nevojave konkrete, si për stafin akademik, ashtu edhe për studentët e këtij programi studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ, bazuar në vizitën në institucion si dhe nga shqyrtimi i RVB, konstatoi se institucioni ka politika dhe procedura të institucionalizuara të cilat mbulojnë të gjitha aspektet e ciklit të studimeve duke filluar që nga kriteret e hyrjes së studentëve, transferimet e tyre, kalimin nga një vit në tjetrin, dhe diplomimin në përfundim të ciklit të studimeve. Të gjitha kriteret e përgjithshme dhe specifike janë hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, dhe udhëzimet e MAS. Rregullorja e IAL përcakton politikat dhe procedurat në lidhje me kuotat e studentëve për çdo vit akademik në bazë të kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore. Bazuar në aplikimet e marra përmes portalit U-Albania, përgatit listën e studentëve fitues dhe pas publikimit në portalin e U-Albania ato publikohen edhe në faqen web të institucionit.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ, gjatë vizitës në institucion në takimin me Përgjegjësin e Departamentit dhe sidomos GVB, u informua se numri i studentëve që pranohen në këtë program studimi propozohet nga Departamenti. Kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi duhet të plotësojnë kriteret ligjore të cilat lidhen kryesisht me pasjen e një diplome bachelor në një fushë të përngjashme me fushën e studimit të programit. Statuti dhe Rregullorja e IAL përmbajnë në mënyrë të detajuar të gjitha proceset nga regjistrimi, deri tek përfundimi i studimeve apo transferimet në programe të tjera studimi duke ofruar transparencë në proces dhe barazi në trajtimin e studentëve. Të gjitha ambientet dhe godinat e institucionit janë pajisur me ashensorë ose me rampa për të mundësuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara. Evidenca I.1: Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër

	Evidenca I.2: Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evidenca I.4: Rregullore e studimeve të UGJ
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Institucioni harton dhe zbaton në regjistrimin e studentëve në respekt të legjislacionit në fuqi sic janë Ligji 80/2015 miratuar nga MAS dhe Këshilli i Ministrave si edhe kuadrin ligjor institucional. Universiteti shikon cdo vit listat e aplikantëve për secilin program dhe kryen renditjen e fituesve, në përputhje me kuotat e miratuara nga Ministria dhe i gjithë informacioni i referuar pranimit dhe transferimit publikohet në faqen kryesore të institucionit dhe në rrjetet sociale (https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit).
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Nga analiza e RVB GVJ identifikoi se IAL harton e publikon çdo vit akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve. Kriteret e pranimit për programin rishikohen çdo vit nga departamenti në bashkëpunim me njësinë kryesore dhe janë në përputhje me LALKSH 80/2015, me rregulloren e fakultetit dhe rregulloren e programit të studimit. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, pranimit përgjatë kursit të studimit, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe njëkohësisht ato gjenden në seksionin “Njoftime”. Gjithashtu, ekziston dhe zyra e specialistit të Marrëdhënieve me publikun dhe Koordinatori për Konsultimin Publik. Informacioni mundësohet nëpërmjet faqes zyrtare web të Universitetit (www.uogj.edu.al) dhe sekretarisë mësimore të FE. Evidenca I.2: Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evidenca I.4: Rregullore e studimeve të UGJ
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e	Përpara fillimit të çdo viti akademik, universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër informon të gjithë të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, nëpërmjet zyrës së Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar në bashkëpunim me

kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Fakultetet e tij, përfshirë dhe Fakultetin Ekonomik, realizojnë komunikimin me publikun e interesuar për ndjekjen e programeve të studimit, nëpërmjet: Publikimit në faqen e web; Organizimit të takimeve promovuese; Infomimit nëpërmjet rrjeteve sociale, lokale, fletëpalosjeve dhe posterave. Evidenca V.2.1: Kriteret e pranimi viti akademik 2024-2025
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë parashikon kuota dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara si dhe zbaton udhëzimet përkatëse për aplikimin dhe regjistrimin e tyre. Evidenca V.2.: Kuotat e pranimi viti akademik 2023-2024 Evidenca V.2.1: Kriteret e pranimi viti akademik 2024-2025
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë parashikon kuota dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera dhe kryesisht nga Republika e Kosovës dhe trojet shqiptare (Maqedoni e Veriut, Mal i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë) dhe të Huaj. Evidenca V.2.: Kuotat e pranimi viti akademik 2023-2024 Evidenca V.2.1: Kriteret e pranimi viti akademik 2024-2025
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Nëpërmjet vendimarrjeve dhe procedurave përkatëse institucionale, institucioni implementon politikat e ndihmës/bursave për shtresat në nevojë si dhe për rritjen e cilësisë së pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Evidenca II.14.: Vendime Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta.
Konkluzione	<i>Institucioni ka hartuar dhe zbaton procedura dhe politika të qarta për pranimin e studentëve në programet akademike dhe përzgjedhjen e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi. Procedurat e pranimi realizohen mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit, si edhe sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.</i>

	<i>Institucioni ka për detyrë që i gjithë informacioni duhet të gjendet dhe i afishuar pranë sekretarive.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Procedurat e progresit akademik përcaktohen në rregulloret e IAL dhe njësisë bazë që ofron programin të cilat u vihen në dispozicion studentëve. Po aq e rëndësishme sekretaria mësimore është në dispozicion gjatë gjithë vitit akademik për të informuar dhe ndihmuar studentët në lidhje me orarin mësimor, frekuentimin, datat dhe provimeve. Si rregull, studenti njihet me rregulloren e programit, e cila përcakton kriterit e progresit në varësi të përmbushjes së kërkesave akademike. Informacioni zyrtar mbi notat është pjesë e sistemit të menaxhimit të universitetit. Informacionet në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin janë të përshkruara hollësisht në Rregulloret institucionale. <i>Evidenca I.2.: Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e Departamentit përcaktohen procedurat dhe kriteret që ndiqen për transferimin e studentëve nga shkolla të tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni i njohjeve dhe ekuivalentimit të lëndëve mësimore, i ngritur pranë NJBAP. <i>Evidenca I.2.: Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër</i>

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregullorja e UGJ, FE dhe e programit të studimit qartësisht kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentit duke përfshirë gjithashtu dhe mënyrat e zhvillimit të provimeve, të drejtën e studentëve për të hyrë në provime, komunikimin e vlerësimeve dhe dokumentin e këtyre vlerësimeve. <i>Evidenca I.2.: Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë</i> <i>Evidenca I.4.: Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë</i> <i>Evidenca I.5.: Rregullore e Fakultetit Ekonomik</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Nga analiza e rregullores së institucionit, njësisë kryesore dhe asaj bazë, GVJ vëren se kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit janë të përcaktohen qartë dhe saktë. Specifikisht Rregullorja e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë dhe Rregullorja e Universitetit përcaktojnë parakushtet, kriteret dhe procedurat për projektin e diplomimit. Informimi i studentëve lidhur me këto kërkesa dhe procedura zhvillohet nga departamentit. Për të plotësuar këto parakushte, studentët kanë të drejtë të hyjnë në provime plotësuese jo më shumë se tre herë. <i>Evidenca I.4.: Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, organizon takime të hapura dhe publikon udhëzues të posaçëm për informimin e të interesuarëve mbi programet e studimit të ciklit të dytë. Institucioni informon gjithashtu edhe nëpërmjet spoteve televizive dhe fletëpalosjeve promovuese në lidhje me programet e studimit që ofron.
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika të qarta dhe të sakta për informimin e studentëve aktual dhe potencial mbi të gjitha elementët e programit të studimit. Proçedura të vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit.</i>

	<i>Institucioni ka përgatitur dhe një manual udhëzues për përgatitjen e temës së diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Rregullorja e studimeve, Rregullorja Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër si dhe Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Publik” përcaktojnë qartë strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik, organizohen takime informuese me studentët e vitit të parë të ciklit të dytë të studimeve, ku informohen rreth procesit mësimor, strukturës mësimore të vitit akademik, kohëzgjatjes së vitit akademik, ndarjes së tij në semestra, sezoneve të provimeve, planit mësimor dhe lëndëve mësimore përkatëse. Informacionet e mësipërme mund të aksesohen elektronikisht edhe nëpërmjet faqes zyrtare web të Universitetit. <i>Evidenca I.4.: Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Universiteti vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master Profesional në “Administrim Publik” informacion dhe dokumentacion udhëzues si Rregulloren e programit të studimit, plan mësimor me lëndët përkatëse, programet lëndore, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të tyre. <i>Evidenca I.4.: Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si	Institucioni mbështet institucionalisht studentët dhe i orienton drejt tregut të punës. Një formë është pjesëmarrja në panairin e punës, ku shumë studentë prezantohen me informacione për




dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	punësim dhe punëdhënës të ardhshëm potencialë. Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar u shërben studentëve si urë lidhëse me tregun e punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit. Institucioni ka realizuar një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme, të cilat krahas ndihmës për procesin mësimor kanë shërbyer dhe si pikë tërheqjeje për punësimin e studentëve që përfundojnë studimet në institucion.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga sa kemi thënë më sipër, bazuar në RVB si dhe në vizitën në institucion, studentëve i vihet në dispozicion i gjithë informacioni i nevojshëm. Një përshkrim i plotë i ambienteve të logjistikës ofrohet që në fillim të programit, ndërsa gjatë vizitave të organizuara në institucion, studentët apo kandidatët informohen mbi shërbimet e ofruara për studentët, informacionet lidhur me programin e studimit, logjistika institucionale, etj. Këto informacione ofrohen edhe gjatë ditëve të hapura të organizuara në fillim të çdo viti akademik për këtë qëllim nga të gjitha strukturat e IAL në shërbim të studentit por edhe nga pedagogu gjatë javës së parë në prezantimin e çdo lënde.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet dhe është lehtësisht i arritshëm dhe nga studentët dhe në distancë, nëpërmjet faqes zyrtare të web, postës elektronike si dhe sistemit të sekretarisë mësimore. Gjatë situatës së pandemisë, insitucioni e zhvilloi procesin e msimdhënies online nëpërmjet platformës Teams, duke përmbyllur me sukses vitin akademik.			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika të qarta e të institucionalizuara mbi informimin e studentëve për organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme dhe mundësitë e punësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ vëren se në nivel institucional, insitucioni mban një bazë të dhënash mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar në programin e studimit. Specifikisht, sekretaria mësimore mban statistika mbi numrin e të diplomuarve, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në sekretarinë mësimore. Këto të dhëna dokumentohen në “Raportin Vjetor”, i cili përgatitet nga Zyra e Karrierës si pjesë e detyrimit ligjor të IAL. Të dhënat që përpunohen nga Zyra e Karrierës përfshijnë punësimin e studentëve, si edhe përputhshmërinë e punësimit me drejtimin e diplomimit. Mbajtja e të dhënave është relativisht e lehtë duke patur parasysh edhe numrin e ulët të studentëve. <i>Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i> <i>Evidenca III.13.: Rregullore sekretarisë mësimore</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, klasifikimin e studentëve të rinj në programet e studimi sipas gjinisë, grupmoshave dhe vendbanimeve, të diplomuar, të tërhequr apo të larguar përpara diplomimit. Të dhënat e gjeneruara nga sekretaria mësimore përfshihen në raportet vjetore të veprimtarisë së institucionit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se numri i studentëve për tre vite akademike është si vijon: Viti akademik 2020 – 2021 44 studentë; Viti akademik 2021 – 2022 32 studentë; Viti akademik 2022– 2023 17 studentë;
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht	Sekretaria mësimore regjistron informacionin (notën) mbi ecurinë e studentëve gjatë programit të studimit deri në diplomim. Të dhënat mbahen elektronikisht dhe në <i>hard copy</i> në regjistrat e notave dhe të diplomave të Sekretarisë Mësimore. Ndërsa të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin

të verifikueshme nga personat e autorizuar.	themeltar. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore GVJ vuri re se të dhënat ishin të sakta dhe të mbajtura sipas kërkesave ligjore.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Për të kryer auditimin e brendshëm të njësive administrative, institucioni ka ngritur Grupin e Auditimit të Brendshëm, i cili ka si objektiv kontrollin në mënyrë periodike të procedurave dhe rregullave të përshkruara në rregulloren e funksionimit të zyrave administrative. Grupi i Auditimit përpilon një raport vjetor ku përfshihen mangësitë e vërejtura si edhe ofrohen sugjerime për përmirësimin e tyre duke u udhëhequr nga Politika e Cilësisë.			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	GVJ konstaton se njësia bazë ndërmerr periodikisht analiza të tilla. Gjithësesi, duke qenë se ky program studimi ka një numër të ulët studentësh, mund të kryhen vetëm 'analiza' deskriptive dhe jo shumë të dobishme. Me vlerë do të ishte një studim mbi arsyet e numrit të ulët të studentëve dhe mënyrave për ta adresuar atë.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka politika të qarta dhe zyra të dedikuara për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për profilin dhe studentëve të programit të studimit. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në statutin e tij, institucioni nxit, përfshin dhe angazhon studentët dhe/ose përfaqësues të tyre në organet kolegjiale të tij. Studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik, Këshillin e Etikës, janë të organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë statutin e organizimit dhe funksionimit të tyre. Gjithashtu, janë të përfaqësuar në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (megjithëse kjo strukturë sapo ishte ngritur) dhe kanë shoqatën sportive studentore të tyre. <i>Por jo studentë nga ky program studimi.</i> Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evidenca V.8.: Rregullore e organizimit të zgjedhjeve për Këshillin Studentor Anekset: Tabela nr.24
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Bazuar në analizën e GVB dhe vizitën në institucion, GVJ rekomandon rritja e përfshirjes së studentëve në veprimtaritë kërkimore të Njësisë Bazë, duke krijuar mundësi konkrete për angazhimin e tyre aktiv në projekte që lidhen drejtpërdrejt me këtë program studimi. Specifikisht, saknsonon të drejtën e studentëve për tu përfaqësuar në vendimmarrje në instanca si: Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Bordi i Etikës, dhe Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët. Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të	Nga analiza e RVB dhe vizita në institucion, GVJ evidenton se ky program studimi është brenda parametrave ligjore dhe sidomos ngarkesës akademike të studentëve dhe ndarjes sipas Veprimtarive Formuese nga A në E në përputhje me kërkesat e VKM nr. 41. Si anëtarë të Senatit Akademik dhe Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që janë

rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	organet kompetente për hartimin dhe kontrollin e zbatimit të programit, studentët janë pjesë e procesit të hartimit dhe përmirësimit të programeve. Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në rregulloren e njësisë bazë, studentëve të këtij programi ju mundësohet e drejta për ankimimin e rezultatit dhe rishikimin e rezultateve dhe reflektimin e ndryshimeve. Specifikisht, studenti ka të drejtën e ankimimit për notën e provimit brenda 5-ditëve nga marrja e notës. Çdo kërkesë, ankimim prej studentëve në lihje me saktësinë dhe korrektësinë e vlersimit të dijeve nëpërmjet të gjitha formave të kontrollit, parashikohet në Rregulloren e studimeve. Ankesa bëhet me shkrim dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit, i cili përcakton nëse kërkesa është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë Evidenca I.4.: Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë			
Konkluzione	<i>Studentët janë të përfaqësuar në Senatin e Universitetit me një senator i cili zgjidhet nga vetë ata. Studentët janë pjesëmarrës në Këshillet studentorë, në Komisionin e përhershëm për standartet e cilësisë, etj. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB.</i> <i>Rekomandohet rritja e përfshirjes së studentëve në veprimtaritë kërkimore të Njësisë Bazë, duke krijuar mundësi konkrete për angazhimin e tyre aktiv në projekte që lidhen drejtpërdrejt me këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Drejtoria e Shërbimeve ndihmës-Akademike Administrative dhe Sektori i Shërbimeve Bibliotekare Arkivore dhe studentore, nëpërmjet zyrës së Alunit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar informojnë dhe mbështesin studentët pr të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor, shpërndarjen e informacionit për orientimin e aplikantëve dhe studentëve të rinj, dhënien e informacioneve për programet, kurrikulat e studimeve, diplomat, këshillimin e studentëve që përfundojnë nivelin e dytë të studimeve për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve të institucionit, ofron për studentët trajnime, takime të hapura etj. Informimi i studentëve realizohet edhe nëpërmjet Sekretarive mësimore, Zyrës së IT, Drejtorisë së Shërbimeve Universitare, Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ku studenti merr informacionin e nevojshëm në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike, diplomimin, detyrimet dhe shërbimet financiare. Rol të rëndësishëm ka dhe NJBAP. <i>Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i> <i>Evidenca IV.6.: Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin	Informimi, këshillimi, ndjekja dhe pranimi i studentëve dhe mbështetja e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit realizohet nëpërmjet: Njesisë bazë, Sekretarisë Mësimore të FE, Sektorit të Standardeve dhe Kurrikulave, Zyrës së Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, Faqes zyrtare web, Sistemit të Sekretarisë Mësimore (Pitagora), adresave zyrtare elektronike, njoftime në rrjete sociale.

mësimor dhe programin e studimit.				
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar fokusohet në përthithjen e nevojave të tregut të punës dhe këshillimin e studentëve lidhur me këto nevoja dhe ndan këtë informacion si me Zyrën e Cilësisë ashtu edhe me departamentet përkatëse në mënyrë që programet e studimit të përgatisin studentë me profile sa më të kërkuara në tregun e punës. Kjo Zyrë i ofron studentëve këshillat e nevojshme lidhur me mundësitë e karrierës nëpërmjet takimeve individuale, panairove dhe workshopeve tematike të organizuara për këtë qëllim, si edhe nëpërmjet informacionit të publikuar lidhur me analizat mbi tregun e punës, të cilat publikohen në të gjitha kanalet e institucionit.			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Alumnit, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.			
	<i>Evidenca V.13.: Informacion mbi gjurmimin e studentëve dhe formular kontakti</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ka politika të qarta për këshillimin e studentëve dhe lidhjen e tyre organike me tregun e punës. Kjo zyrë mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit, si dhe ka krijuar një data - bazë të të dhënave, të cilat përditësohen çdo vit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Harton udhëzues, manuale dhe kryen trajnime në nivel institucional, për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. Mësimdhënia përfshin përveç metodave didaktike tradicionale dhe metoda didaktike inovative, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie. <i>Evidenca I.9.: Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Administrim Publik”</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative. Për këtë funksion Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK) me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. SSCK bazuar në statutin e institucionit, kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore shkencore, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, realizon studime për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe




	efikasitetin e programeve të studimit të ofruara, organizon vlerësimin periodik të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Universiteti inkurajon përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, si edhe ofrimin e sugjerimeve nga studentët duke e konsideruar si një shtytës për të arritur objektivat e mësimdhënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë sapo kishte filluar të funksiononte dhe po punonte në drejtim të hartimit të pyetësorëve në rang institucional me qëllim jo vetëm të përmirësimit të metodologjisë mësimore, por edhe sjelljen në vëmendje të zërit të studenteve. Megjithatë, mënyra për të shprehur shqetësimet apo sugjerimet e studentëve ekziston nëpërmjet procesit të ankimimit pranë Dekanit të Studentëve. Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evidenca I.4.: Rregullore e studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër Aneks: Tabela 24
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Spektori i Sigurimit të Cilësisë mbështetur në Statutin e institucionit, harton dhe bën publike rezultatet e vlerësimit duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, së bashku me raportet përkatëse. Institucioni nëpërmjet faqes zyrtare të web (https://uogj.edu.al/transparenca/), pasqyron në mënyrë transparente dhe bën publike politikat, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për studentët dhe të interesuarit, në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evidenca VI.3.: Raport vjetor i sektorit të standardeve të cilësisë së kurrikulave 2021-2022 Aneks: Tabela 24
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj	Përsa i përket mekanizmave të vlerësimit, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sapo kishte filluar të funksiononte, ende nuk ishte organizuar ndonjë pyetësor për matjen e cilësisë në nivel institucional, por ishin bërë disa anketa të thjeshta, si njësi

të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	matëse e cilësisë brenda departamentit. Ishte punuar mbi rezultatet e marra, për të konkluduar rreth përmirësimit të mësimdhënies apo promovuar shembuj të praktikave të mira. Ende mungon, megjithëse po punohet në proces për hartimin e një pyetësoi në nivel institucional si instrument i rëndësishëm për përmirësimin e veprimtarive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore të personelit akademik. Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër Evidenca VI.3.: Raport vjetor i sektorit të standardeve të cilësisë së kurrikulave 2021-2022 Aneks: Tabela 24			
Konkluzione	<i>Sektori i Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK) me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore shkencore. Njësia e Sigurimit të Cilësisë sapo kishte filluar të funksiononte ende nuk ishte organizuar ndonjë pyetësor për matjen e cilësisë në nivel institucional, por ishin bërë disa anketa të thjeshta, si njësi matëse e cilësisë brenda departamentit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika,	Universiteti mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të

struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Brendshëm të Cilësisë. NJSBC si strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në universitet, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë. Në statut dhe në rregulloren e institucionit përcaktohen qartë politikat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evidenca VI.4.: Rregullore e NJSBC
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë, zbaton strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe bashkëpunon me aktorë të ndryshëm ku pëfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm për të hartuar dhe organizuar një pyetësor të matjes së cilësisë në nivel institucional. NJSBC është strukturë pranë Rekoratit, i cili përbëhet nga 7 anëtarë, 4 përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, 2 përfaqësues administrativ dhe 1 përfaqësues studentor. Në bazë të statutit të institucionit për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional përfshihet një përfaqësues nga organizata studentore. Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evidenca VI.4.: Rregullore e NJSBC Aneks: Tabela 24
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve	Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Në funksion të sigurimit të cilësisë, institucioni ka realizuar me sukses procesin e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë. Ka marrë akreditimet periodike me Vendim Nr. 67 datë 21.09.2017 dhe Vendim Nr. 55 datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL.

analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Evidenca I.21.: Vendim i Akreditimit Institucional Periodik			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se strukturat e ngarkuara për sigurimin e cilësisë, megjithëse në hapat e para të funksionimit, bashkëpunojnë me departamentet në hartimin e formave të ndryshme të vlerësimit të stafit akademik apo programit të studimit, gjenerojnë analiza dhe raporte të vazhdueshme duke përfshirë format e vlerësimit të pedagogëve të përmendura më lart. Sektori i Sigurimit të Cilësisë bazuar në statutin e institucionit kryen porcesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimor shkencore. Gjithashtu bashkëpunon me departamentet për të organizuar pyetësorë studentorë për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit të ofruara, duke evidentuar sukseset dhe të metat me qëllim marrjen e masave për përmirësim në të ardhmen. Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër Evidenca VI.3.: Raport vjetor i sektorit të standardeve të cilësisë së kurrikulave 2021-2022 Aneks: Tabela 24			
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni ka krijuar dhe zbatuar në mënyrë kapilare procedura të dedikuara e publike për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Informacioni i siguruar nga këto struktura i përcillet drejtuesve të cilat i përdorin për të përmirësuar politikat e brendshme dhe orientuar burimet mbështetëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Departamenti është struktura përgjegjëse për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Procesi i mbikëqyrjes së programeve të studimit dhe stafit akademik bazohet në analizën e objektivave të vendosura si në nivel individual ashtu edhe në nivel departamenti duke u bazuar në politikën për përmirësimin e vazhdueshëm. Në përfundim të vitit akademik bëhet hartimi i raporteve në nivel departamenti dhe fakulteti, ku përshkruhen të gjitha aktivitetet e kryera si edhe propozimet për përmirësimin e programeve mësimore, të cilat shqyrtohen nga Senati Akademik. IAL zhvillon analiza vjetore për vlerësimin e ecurisë së studentëve në programet e studimit, ku përfshihen të dhëna për aspektet akademike dhe performancën e studentëve, nivelin e kalueshmërisë, shkallën e diplomit dhe punësimit, etj, të cilat integrohen në raportet vjetore të njësive bazë. Të gjitha raportet e hartuara përmbledhen në raportin përfundimtar institucional, i cili miratohet në Senat dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga	Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfthuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se raportet e vlerësimit përfshijnë sugjerimet e studentëve falë anketave të përgatitura 2-3 herë në vit, kontributin e Dekanit Studentor, arritjet e personelit akademik si dhe identifikojnë praktikën më të mira. <i>Evidenca VI.3.: Raport vjetor i sektorit të standardeve të cilësisë dhe kurrikulave</i>

personeli akademik dhe studentët.	
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër përdor një sërë mekanizmesh për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë si vlerësimet e studentëve, kolegëve, alumni dhe partnerëve të IAL. Një tjetër mekanizëm i përdorur për rritjen e cilësisë është edhe organizimi i seminareve akademike, procesi i rishikimit të sillabuseve ku merret në konsideratë edhe mendimi i studentëve, procesi i monitorimit të programeve mësimore, etj të cilat bëhen transparente për të zbatuar një proces sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës. <i>Evidenca I.11.: Raport vjetor i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin	Nga analiza e RVB, nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se të gjitha grupet e interesuara si studentët aktualë apo ata të diplomuar, stafi akademik dhe administrativ përdorin instrumentat e lartë-përmendura për të bërë vlerësimin e performances së programeve të studimit. Po aq e rëndësishme, Zyra e Keshillimit të Karrierës dhe të Diplomuarve mban kontakte të vazhdueshme me Alumni duke i angazhuar në aktivitetet e organizuara nga universiteti dhe duke thithur mendimin e tyre dhe të insitucioneve partnere. Shumë prej tyre marrin pjesë në Panairët apo aktivitetet e tjera tematike të cilat organizohet në manyrë periodike në nga IAL. Gjithashtu, në bazë semestrale zhvillohet një rishikim i përmbatjes së lëndëve dhe rezultateve dhe nga Bordi i provimeve i cili përgatit një raport vjetor.

apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni monitoron periodikisht cilësinë dhe i përdor këto të dhëna për të adresuar problematikat e identifikuar dhe replikuar praktikrat e mira.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	IAL siguron një përfshirje të të gjithë aktorëve të jashtëm dhe të brendshëm të sigurimit të cilësisë, falë strukturave të ngritura dhe procedurave të zbatuara në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si edhe me Manualin “Per Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”. NJSBC si strukturë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë mbështeten nga eksperti i jashtëm dhe nga ai ligjor në përmbushjen e detyrave dhe bazohen në përmbushjen e procedurave të sanksionuara në Manualin e Cilësisë.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni përcakton qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të detyrave. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, Njësia Bazë e Administrimit Publik ka krijuar grupet e punës që sigurojnë këtë të fundit në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve. <i>Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i>

	<i>Evidenca I.7.: Rregullore e Njesisë Bazë të Administrim Publik</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Pas shqyrtimit të rregullores dhe manualit, GVJ konstaton se, siç u shprehëm edhe më sipër, se ka një përfshirje të strukturuar të aktorëve të jashtëm në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Specifikisht, njësia bazë është përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e të gjithë këtyre formave të monitorimit dhe bën të mundur analizimin e të dhënave të marra dhe përgatitjen e hapave për përmirësimin e problemeve të identifikuar dhe përgjithësimin e praktikave të mira. Në statutin e institucionit është parashikuar dhe ngritja në nivel fakulteti e komisioneve të garantimit të cilësisë s njësisë kryesore dhe programeve të studimit me përfaqësues të personelit akademik dhe atij ndihmës administrativ me karakter mësimor dhe përfaqësues të studentëve. DKF është përgjegjës për programet e studimit që ofron, si dhe sigurimin brendshëm të cilësisë së këtyre programeve në bashkëpunim me të gjitha strukturat e institucionit, kjo bazuar në mekanizmat e sigurimit të cilësisë dhe akteve rregullatore që institucioni ka parashikuar. <i>Evidenca I.1.: Statuti i Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i> <i>Evidenca I.2.: Rregullore e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër</i> <i>Evidenca I.7.: Rregullore për orgaizimin dhe funksionimin e DSHNA</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Proceset e vlerësimit respektojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Respektojnë lirinë dhe etikën akademike. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit, realizohet nga studentët e kursit në mënyrë anonime duke ruajtur konfidencialitetin e tyre.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe	Pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, janë edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo që mund të japin ekspertizë në lidhje me cilësinë e programit të studimit dhe

bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	përmirësimin e tij. Pjesëmarrja dhe promovimi i programeve të studimit nëpër eventet e ndryshme të zhvilluara nga NJBAP, në bashkëpunim me zyrën e Alumni, Këshillit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, në bashkëpunim me maturantët, studentët dhe aktorët e tjerë nga tregu i punës, iu mundëson studentëve qasje më të mirë të tregut të punës si dhe mundësi punësimi e intershipi.			
Konkluzione	<i>Institucioni ka politika të qarta për promovimin dhe sigurimin e cilësisë si dhe përfshirjen e aktorëve të brendshëm të IAL në këtë proces. IAL përdor disa mjete për monitorimin e cilësisë dhe përfshin: a) njësitë akademike nëpërmjet monitorimit periodik; b) personelin akademik; c) studentët në nëpërmjet anketave dhe mekanizmave të ankimit në proceset e kontrollit të cilësisë së programit të studimit; d) anketimet e kompanive dhe alumni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Statutin në Rregulloren e Institucionit, por edhe në politika specifike për përmirësimin e cilësisë. Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka politika të qarta dhe njësi të dedikuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë sipas kërkesave ligjore. Nga vizita u konstatua që raportimi në RVB përputhej me situatën reale. Pegadogët bënë vetëvlerësim, zyra e sigurimit të cilësisë kryente sondazhet, të dhënat përpunoheshin dhe problematikat e identifikuar përcilleheshin dhe adresoheshin në instancat e përshtatshme.

Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë në publikimin e rezultateve dhe vlerësimin e programeve të studimit, respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Procedura e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit që ofron njësia bazë, miratohet me Vendim të Senatit Akademik. Raportit i bashkëngjiten dhe projektpropozimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë duke e përcjellë më tej pranë strukturave përkatëse të parashikuara në procedurën e analizës së pyetësorëve. Në përfundim të zbatimit të të gjithë fazave të parashikuara në procedurën e mësipërme përpilohet plani i masave për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit dhe mësimdhënies, i cili përcillet për miratim pranë Senatit Akademik të institucionit. <i>Evidenca I.21.1.: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e planit të veprimit</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Harmonizimi i strukturave të ndryshme të institucionit me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë siguron koherencë dhe gjithëpërfshirje në drejtim të sigurimit të cilësisë falë mbledhjes së të dhënave dhe analizës së informacionit duke hartuar sugjerimet dhe përmirësimet përkatëse. Kjo njësi harton një raport vjetor ku përfshihen veprimtarinë që këto struktura kanë realizuar për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet e programeve mësimore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Për të përmirësuar më tej metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies IAL zbaton aktivitete të ndryshme si bashkëbisedime me studentët dhe stafin, thithjen e mendimeve nëpërmjet anketave me studentë, pedagogë, alumni, kompanitë partnere, vizitat e ekspertëve të huaj akademikë dhe jo-akademikë, organizimi i vizitave studimore dhe kërkimore në terren, si edhe trainime për të kërkuar metodologjitë për ti përmirësuar programet dhe infrastrukturën në dispozicion për të qenë sa më pranë nevojave të studentëve.

	Evidenca VI.6.: Takime të studentëve me ALUMNI Evidenca II.16.: Lista e aktiviteteve kulturore, sociale dhe shkencore me pjesëmarrjen e studentëve			
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni zhvillon procese dhe veprimtari të cilat janë publike dhe në tërësi efikase për krijimin dhe institucionalizimin e një kulture cilësie dhe përmirësimi të vazhdueshëm të programit të studimit. NJSBC-ja vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore të institucionit e për këtë harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm ku adresohen pikat e forta dhe të dobëta, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. GVJ gjykon që aktiviteti dhe funksioni i NJSBC-së në monitorimin e vlerësimit të cilësisë në përmirësim në vijim të cilësisë së programit të studimit të përmirësohet. Mungon një vlerësim i treguesve cilësorë në nivel institucional. Po ashtu, GVJ gjykon si të domosdoshme ngritjen e Grupit të përhershëm të vlerësimit të brendshëm, në rang fakulteti. Ky organizëm do të ketë rol të rëndësishëm në monitorimin dhe vlerësimin periodik të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	




Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në
“Administrim Publik”

Pika të forta:

1. Integrimi i teorisë me praktikën:

Programi përfshin lëndë që sigurojnë kombinimin e njohurive teorike dhe aftësive praktike për të përgatitur studentët.

2. Marrëveshjet e bashkëpunimit:

Universiteti ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare për të mundësuar praktikat profesionale dhe për të përmirësuar përmbajtjen e programit.

3. Struktura e qartë dhe e organizuar e programit:

Programi është i strukturuar mirë me ndarje të balancuar të lëndëve dhe ngarkesës mësimore në përputhje me standardet europiane ECTS.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e një studimi të mirëfilltë të tregut të punës:

Nga Njësia Bazë e Administrimit Publik mungon një studim i mirëfilltë lidhur me identifikimin e nevojave dhe kërkesave të tregut të punës përsa i përket studentëve që diplomohen në këtë program studimi.

2. Mungesa e një platforme për mbështetjen e kërkimit shkencor:

Nuk ka një platformë strategjike për mbështetjen e kërkimit shkencor për studentët e këtij programi studimi.

3. Numri i ulët i studentëve të regjistruar në programin e studimit:

Kjo mund të pengojë në aplikimin e drejtë të të gjithë mekanizmave të dedikuara për cilësinë e programit të studimit.

4. Mungesa e një monitorimi të treguesve cilësorë në nivel institucional:

GVJ gjykon që aktiviteti dhe funksioni i NJSBC-së në monitorimin e vlerësimit të cilësisë në vijim të programit të studimit të përmirësohet. Mungon një vlerësim i treguesve cilësorë në nivel institucional.

Rekomandime:

1. Rekomandohet të rishikohet literatura duke përditësuar dhe përfshirë në tekste apo cikle leksionesh të 5 viteve të fundit
2. Rekomandohet rritja e përfshirjes së studentëve në veprimtaritë kërkimore të Njesisë Bazë, duke krijuar mundësi konkrete për angazhimin e tyre aktiv në projekte që lidhen drejtpërdrejt me këtë program studimi.



3. Rekomandohet një administrim më efektiv i buxhetit nga Njësia Bazë e AP, për të mundësuar identifikimin dhe adresimin e nevojave konkrete, si për stafin akademik, ashtu edhe për studentët e këtij programi studimi.
4. GVJ rekomandon që aktiviteti dhe funksioni i NJSBC-së në monitorimin e vlerësimit të cilësisë në përmirësim në vijim të cilësisë së programit të studimit të jetë më mirë i organizuar, më i plotë dhe i shpeshtë.

Strengths:

1. **Integration of Theory and Practice:**

The program incorporates courses that ensure the combination of theoretical knowledge and practical skills, effectively preparing students for the job market.

2. **Collaboration Agreements:**

The university maintains partnerships with national and international institutions to facilitate professional internships and enhance the program's content.

3. **Clear and Organized Structure of the Program:**

The program is well-structured, with a balanced distribution of courses and workload, adhering to European ECTS standards.

Weaknesses:

1. **Lack of a Comprehensive Labor Market Study:**

There is no thorough study conducted by the AP Basic Unit to identify the needs and demands of the labor market concerning the employment of graduates from this program.

2. **Absence of a Strategic Research Support Platform:**

The program lacks a strategic platform to support research activities for students.

3. **Low Student Enrollment:**

The low number of students in the program may hinder the proper application of mechanisms dedicated to ensuring the quality of the study program.

4. **Absence of institutional monitoring of quality indicators at the institutional level:**

There is no questionnaire at the institutional or even faculty level to monitor the quality indicators of the learning process.



Recommendations:

1. Revise and update the program's literature to include materials and lecture cycles from the last five years.
2. Increase student involvement in research activities by creating concrete opportunities for their active participation in projects directly linked to the program.
3. Improve budget management to enable the identification and addressing of specific needs for both academic staff and students within the program.
4. The institution should work towards improving the function of the Internal Quality Assurance Unit because there is a lack of institutional monitoring of quality indicators at the institutional level.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

